



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	793-03-1
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	36	Data Datum Date	11/10/23

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica - Municipality of Mitrovica North

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

Nr. _____, Data: 11.10.2023.

Mitrovicë Veriore.

RREGULLORE KOMUNALE NR. 01/2023 PËR SHËRBIME KOMUNALE NË MITROVICËN VERIORE

Tetor 2023, Mitrovicë Veriore

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për “Vetëqeverisjen lokale” respektivisht të Nenit 11, Nenit 12 (pika 12.2, nën pika C), Nenit 34 (pika 34.4) dhe Statutit të Komunës së Mitrovicës Veriore respektivisht të Nenit 15, Paragrafi 15.1, në mbledhjen e mbajtur me datë 10.10.2023 Kuvendi miraton këtë:

RREGULLORE KOMUNALE NR. 01/2023 PËR SHËRBIME KOMUNALE NË MITROVICËN VERIORE

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Qëllimet

- 1.1 Qëllimi i kësaj rregullore është sigurimi i qeverisë lokale të mbetët e fortë, e qëndrueshme në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor, fleksibilitet dhe përgjegjshme para banoreve të saj.
- 1.2 Të zbatoj kornizën ligjore dhe të merr vazhdimisht sugjerime nga banorët e saj, ekspertet dhe palët tjera të interesuar për rritjen e kualitetit të jetesës dhe mirëqenien e banoreve të saj.
- 1.3 Të rrisë aktivizimin qytetarë në vendimmarrje, të rrisë transparencën dhe llogaridhënien.

Neni 2.

Fushëveprimi

- 2.1 Me këtë rregullore përcaktohen të drejtat dhe detyrat e institucioneve lokale, ndërmarrjeve publike, banorëve, këshillave banesore, këshillave të vendbanimeve, bizneseve, organizatave joqeveritare, organizatave qeveritare – politike dhe subjekteve tjera kombëtare dhe ndërkombëtar që veprojnë në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriut.
- 2.2 Kjo rregullore përcakton kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në territorin e komunës, mirëmbajtjen e infrastrukturës teknike dhe hapësirave publike, sigurinë dhe rendin në trafik dhe shfrytëzimin e hapësirave publike.
- 2.3 Po ashtu përcakton edhe masat ndëshkuese ndaj veprimeve kundër kësaj rregullore.

Neni 3.

Shërbimet komunale

Shërbimet publike komunale sipas kësaj rregulloreje janë:

- a) Furnizimi me ujë.
- b) Përcjellja, trajtimi, përmirësimi dhe pastrimi i rrjetit të kanalizimit (ujërave të zeza) dhe rrjetit të ujërave atmosferik.
- c) Rrjeti i ngrohjes qendrore.
- d) Rregullimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi e hapësirave të hapura publike.
- e) Rregullimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi e hapësirave të hapura të gjelbërta publike.
- f) Sigurimi i qasjes për të gjitha shtresat e shoqërisë civile.
- g) Mirëmbajtja e varrezave.

- h) Rregullimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi i terreneve të hapura sportive.
- i) Grumbullimi, bartja e mbeturinave në deponi.
- j) Rregullimi i transportit në nivel lokal (këmbësorë, çiklistë, transportit publik dhe automjetet)
- k) Rregullimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i parkingjeve.
- l) Rregullimi, mirëmbajtja (pastrimi në periudhën verore dhe dimërore) dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore në nivel lokal,
- m) Rregullimi, mirëmbajtja dhe plotësimi i sinjalizimit të komunikacionit.
- n) Emërtimi i rrugëve.
- o) Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik.
- p) Menaxhimi i të gjitha reklamave dhe panove në hapësirat publike dhe në ndërtesa (kjo vlen edhe në rast të dhënies së hapësirave me qera sektorit privat)
- q) Mirëmbajtja dhe rregullimi i lumit dhe kanaleve të hapura të ujit (ujitjeve).

Neni 4

Objektet komunale

Objekte komunale – publike, sipas kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- a) Rrjeti i tërësishëm i ujësjellësit dhe kanalizimit, me të gjitha pajisjet përcjellëse (me këtë pikë nënkuptohet e impianti për trajtimin e ujerave të zeza).
- b) Sheshet dhe shëtitorët
- c) Hapësirat e hapura publike.
- d) Hapësirat e hapura të gjelbra publike (gjelbërimi i ulët, mesëm dhe i lartë)
- e) Monumentet urbane (Simbolet, skulpturat, shtatorët, lapidaret, bustet etj).
- f) Mobilieria urbane.
- g) Rrugët dhe trotualet.
- h) Sinjalizimi në trafik.
- i) Hapësirat për parking (parkingjet) dhe garazhet publike.
- j) Terrenet sportive.
- k) Këndet e lodrave.
- l) Urat.
- m) Varrezat
- n) Rrjeti dhe pajisjet ndriçim publik.
- o) Rrjetet dhe pajisjet e monitorimit (Kamerat e vrojtimit).
- p) Tabelat informuese dhe të shpalljeve.
- q) Panot ndriçuese dhe reklamat në pronat publike (Në përjashtim kur këto panot ndriçuese jepen me qera sektorit privat)
- r) Të gjitha objektet tjera, të cilat, sipas shfrytëzimit që kanë, mund të konsiderohen objekte komunale.

Neni 5

Shfrytëzuesit e objekteve komunale

- 5.1 Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve komunale të cekura në Nenin 4, janë të detyruar që të kujdesen për ato, t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar sipas kësaj Rregulloreje.
- 5.2 Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve komunale të cekura në Nenin 4, janë të detyruar që të mbrojnë ato, ashtu siç shihet në këtë Rregullore.
- 5.3 Qytetarët janë të detyruar që në rastet të dëmtimit, mos funksionimit, keqpërdorimit apo vandalizmit të njoftojnë organet përkatëse.

5.4 Organet kompetente duhet të ofrojnë numrat e telefonit të cilat janë në dispozicion për të gjithë qytetarët për të raportuar dëmtimin, mosfunksionimit, keqpërdorimit apo vandalizmin ndaj objekteve komunale.

2. DISPOZITAT E VEÇANTA

A. Ujësjellësi dhe kanalizimi

Neni 6

Ndërmarrja për ujësjellës dhe kanalizim

6.1 Ndërmarrjet përgjegjëse ujësjellës, kanalizim dhe rrjetet atmosferike (ne vijim vetëm ndërmarrja përgjegjëse), detyrë e të cilave është furnizimi i rregullt i qytetarëve me ujë të pijshëm, përpunimi, pastrimi dhe përcjellja e ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike, bëjnë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve të parapara sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje, gjegjësisht:

- a) bëjnë mirëmbajtjen dhe sigurimin e rregullt të të gjitha objekteve, pajisjeve dhe instalimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe atmosferik;
- b) bëjnë kontrollimin e përhershëm të cilësisë së ujit të pijshëm;
- c) sigurojnë të gjitha masatë e përhershëm të rregullsisë higjienike - teknike të ujit të pijes, sipas dispozitave ligjore për këtë lami;
- d) parandalojnë të gjitha dukuritë negative të cilat mund të kanë ndikim në ndotjen e ujit të pijshëm.
- e) bëjnë ndërtimin dhe rikonstruktimin e objekteve, pajisjeve dhe instalimeve të ujësjellësit kanalizimit dhe atmosferik;
- f) caktojnë kushtet për sigurimin e lidhjeve në rrjetin e ujësjellësit, të kanalizimit dhe atmosferik;
- g) japin lej për qasje në rrjetin e ujësjellësit , kanalizimit dhe atmosferik (për ndërtimet e vjetra dhe për ndërtimet e reja);
- h) bëjnë pastrimin e të gjitha pusetave grumbulluese dhe të pusetave për ujërat atmosferike dhe ujërave të zeza, së paku dy herë në vit (në muajin prill dhe tetor).
- i) I përgjigjen kërkesave të ndryshme të banorëve në lidhje me ujësjellës, kanalizimet dhe rrjetin atmosferik
- j) Bashkërendojnë të gjitha veprimet ne terren me institucionet lokale dhe ndërmarrjet tjera publike.

6.2 Ndërmarrja përgjegjëse, nga pika 6.1 e këtij neni, të gjitha objektet dhe instalimet e ujit, kanalizimit dhe rrjetit atmosferik, i mirëmban në pajtim me këtë Rregullore dhe është e detyruar që t'i mbajë si mjete të veta themelore në shfrytëzim.

6.3 Ndërmarrja përgjegjëse është e detyruar që para çdo intervenimit në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit apo rrjetit atmosferik ti njofton institucionet lokale, banorët, bizneset dhe ndërmarrjet tjera lokale në mënyrë zyrtare dhe nëpërmjet njoftimit publik, mediave lokale e rrjeteve sociale.

Neni 7.

Kualiteti i shërbimeve në ujësjellës

7.1 Mbikëqyrjen e cilësisë së ujit e bën organi kompetent sanitar, sipas dispozitave ligjore, propozon masat nga kompetencat e veta dhe i ndërmerr masat me të cilat sigurohet cilësia e kërkuar.

7.2 Vlerësimin për cilësinë e ujit e jep laborator i ndërmarrjes publike, së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe i vërteton Enti i autorizuar shëndetësor.

- 7.3 Ndërmarrja përgjegjëse për furnizimin me ujë, është e obliguar që të kryej teste të tilla edhe sipas kërkesës së këshillave të banimit, në rastet kur ka dyshim për cilësinë e ujit.
- 7.4 Institucionet lokale e kanë për detyrë të bashkëpunojnë me ndërmarrjen përgjegjëse dhe ti ndihmojnë në rastet kur abuzohet me rrjetin e ujësjellës kanalizimit.
- 7.5 Qytetarët janë të detyruar ti lajmërojnë organet kompetentë në rastet kur hasin në dëmtimin, mosfunksionimit, keqpërdorimit apo vandalizmin (kyçje në mënyrë jo të rregullt, gropime afër rrjeteve ose pompave, dëmtimin e gypave nga faktori njerëzor, dëmtimi i i gypave nga faktori natyror, rrjedhjet e ujit në mënyrë të pakontrolluar etj).
- 7.6 Ndërmarrja përgjegjëse duhet të ofrojë numrat e telefonit të cilat janë në dispozicion për të gjithë qytetarët për të raportuar dëmtimin, mosfunksionimit, keqpërdorimit apo vandalizmin ndaj objekteve komunale.

Neni 8

- 8.1 Të gjithë shfrytëzuesit e ujit të pijshëm të cilët nuk janë të lidhur në mënyrë jo të rregullt në rrjetin e ujësjellësit duhet të bëjnë lajmërimin në ndërmarrjen përgjegjëse dhe të regjistrohen si konsumatorë të rregullt jo më së largu se 2 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

- 9.1 Ndërmarrja përgjegjëse, është e obliguar që shfrytëzuesve t'u sigurojë rregullisht ujë të pijshëm 24/7.
- 9.2 Obligimet nga pika 9.1 nuk vlejnë në rast:
- a) Të ndonjë veprimi të fuqisë natyrore.
 - b) Të pengesave të jashtëzakonshme teknike, të bëra pa fajin e ndërmarrjes nga pika 9.1.
 - c) Të punëve të rregullta ose të jashtëzakonshme për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit.
 - d) Të kryerjes së punëve të reja ose rikonstruktimit të pajisjeve të ujësjellësit.
 - e) Dyshime në kualitetin e ujit.
 - f) Konflikt në investime me ndërmarrjet tjera të cilat e shfrytëzojnë rrjetin nëntokësorë për furnizim siç janë rrjeti i telekomit, rrjeti energjetik, rrjeti i ngrohjes qendrore, rrjeti kabllorik, rrjeti i internetit etj.
- 9.3 Për të gjitha këto raste të furnizimit jo të rregullt me ujë, ndërmarrja përgjegjëse, është e obliguar që, përmes mjeteve të informimit publik, mediave lokale e rrjeteve sociale t'i njoftojë shfrytëzuesit mbi shkaqet dhe periudhën kohore të ndërprerjes së furnizimit me ujë.
- 9.4 Me rastin e ndërprerjeve lokale të furnizimit me ujë, të planifikuara më parë, shfrytëzuesit, së paku 24 orë më parë, duhet të njoftohen për datën dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes.
- 9.5 Përjashtim nga Neni 9.4 dhe Neni 9.5 janë vetëm rastet kur ndërhyrjen në rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit dhe atmosferik janë emergjente por në këto raste institucionet lokale dhe ndërmarrjet tjera lokale duhet të njoftohen për punimet.

Neni 10.

- 10.1 Çdo ndërtesë e cila furnizohet me ujë nga ujësjellësi publik i qytetit, patjetër duhet ta ketë lidhjen e veçantë të ujësjellësit i cili identifikohet me orëmatësin dhe numrin serik.
- 10.2 Objektet nga paragrafi 10.1, duhet të kenë rrjetin e veçantë të kanalizimit i cili lidhet me rrjetin kryesor të qytetit.
- 10.3 Çdo ujëmbledhës brenda pronave private duhet të kanë lidhje me rrjetin kryesor atmosferik të qytetit. Nuk lejohet që të ketë lidhje të ujëmbledhësve brenda pronës private me rrjetin e kanalizimit.

10.4 Çdo investitor i cili e ndërton rrjetin e ri të ujësjellësit ose kanalizimit ose rikonstruktimin e rrjetit ekzistuese të ujësjellësit ose kanalizimit, është i obliguar që përveç linjës kryesore të ujësjellësit ose kanalizimit ti kryej edhe të gjitha lidhjet tjera siç janë të parapare me planin urbanistik (rrjeti i ujërave atmosferik, kanale, drenazhime etj).

10.5 Këto punë duhet t'i kryejë ndërmarrja e autorizuar për këtë qëllim.

Neni 11.

11.1 Ndërtimin e rrjetit të ri nëpër rrugë në të cilat ekzistojnë përcjellësit kryesorë të ujësjellësit dhe të kanalizimit, me kërkesën e investitorit, kryesisht i kryen ndërmarrja përgjegjëse.

11.2 Ndërmarrja përgjegjëse nga pika 11.1, obligohet që gjatë ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe rrjetit atmosferik, t'u përmbahet dispozitave higjienë-teknike gjatë dhe pas kryerjes së punimeve.

11.3 Ndërmarrja përgjegjëse nga pika 11.1 e këtij neni, është përgjegjëse për cilësinë e të gjitha punëve rreth lidhjes me rrjetin gjegjës.

11.4 Ndërmarrja përgjegjëse nga pika 11.1 e këtij neni para fillimit të punimeve duhet ti njofton zyrtarisht institucionet lokale dhe ndërmarrjeve tjera publike për punimet që do të kryhen dhe nuk lejohet asnjë ndërhyrje në rrjetin e ujësjellës, kanalizime dhe atmosferik pa marrjen e pëlqimit të institucioneve lokale respektivisht drejtorisë përgjegjëse (Drejtoria për shërbime publike, infrastrukture, inspektim dhe situatat emergjente - DSHPIISE)

11.5 Pika 11.4 nuk merret parasysh në rastin kur ka dëmtime në rrjet dhe ndërhyrje emergjente për rregullim. Por edhe në këtë rast institucionet lokale dhe ndërmarrjet tjera publike duhet të njoftohen paraprakisht në mënyrë jo zyrtare dhe të dakordohen për fillimin e punimeve – ndërhyrjes në rrjetë.

11.6 Të gjitha dëmtimet të cilat i bëhen rrjeteve tjera (rrjetit energjetik, telekomit, internetit, ngrohjes qendrore) gjatë ndërtimit ose mirëmbajtjes të ujësjellësitkanalizimit dhe atmosferik, pasojat i bart ndërmarrja përgjegjëse (në qoftë se është duke zbatuar investim kapital) ose investitori i cili e realizon këtë projekt.

11.7 Ndërmarrja përgjegjëse është e obliguar që pas përfundimit të punimeve gjendjen në terren ta kthen në gjendjen e saj të mëparshme.

11.8 Ndalohet rreptësisht që gjatë punimeve të dëmtohet gjelbërimi e me theks të veçantë drunjtë.

Neni 12

12.1 Instalimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit lidhen në ujësjellës dhe kanalizimin kryesor të qytetit, me anë të pajisjeve të rrjetit të cilat i përgjigjen kushteve, kritereve dhe standardeve për shërbim të rregullt. Vënia e njave përcjellëse, nënkuptohet bashkimin e rrjetit publik të ujësjellësit deri te ujëmatësi.

12.2 Ndërmarrja përgjegjëse do të mirëmbajë këto rrjete së bashku me nyjat përcjellëse të ujëmatësit.

12.3 Ndërmarrja përgjegjëse nga paragrafi 12.2, është e obliguar që ta mirëmbajë edhe ventilin e parë të ujëmatësit.

Neni 13

13.1 Pronarët që kanë hidroforë dhe ata të cilët furnizohen me ujë në mënyrë jo adekuate, si dhe pronarët e njeve sanitare me gropa septike, janë të obliguar që të bëjnë kyçje menjëherë në nyjat e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, gjegjësisht, më së largu në afatin prej dy muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

13.2 Pika 13.1 nuk vlejnë vetëm në rastet në qoftë se pronarët nuk e kanë rrjetin e kanalizimit afër pronës së tyre (e cila kalon pranë pronës së tyre).

Neni 14

14.1 Ndërmarrjes përgjegjëse ti ofrohen të gjitha të dhënat të cilat i posedon institucioni lokal dhe ndërmarrjet tjera lokale rreth rrjetit nëntokësorë, planeve urbane etj.

14.2 Ndërmarrja përgjegjëse është e obliguar që të harton dokumentacionit teknik të instalimit të ujit dhe të kanalizimit, si dhe të nyjave përcjellëse. Një kopje të këtij dokumentacioni duhet të dorëzohet ne arkivin e komunës. Dorëzimi bëhet ne formën e printuar dhe ne formën digjitale në sistemin koordinativ KOSOVAREF (KOSOVAREF do të përdoret deri ne momentin nëse ajo ndryshon me ndonjë sistem tjetër koordinativ).

14.3 Nyjat përcjellëse mund të ngrihen apo të ulën në bazë të terrenit dhe lejes ndërtimore të lëshuar për ndërtesën e re e cila kërkon kyçje në rrjete

14.4 Leja nga paragrafi 14.4, lëshohet në bazë të dokumentacionit teknik (lejes ndërtimore) për objekte e ndërtuara ose qe do te ndërtohen.

Neni 15.

15.1 Lejen për nyjën përcjellëse në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, e jep ndërmarrja e cila është përgjegjëse për mirëmbajtjen e ujësjellës, kanalizimit dhe atmosferik.

15.2 Lejen për rrëmihje e rrugëve, trotuareve dhe të sipërfaqeve publike për vënien e nyjave në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, e japin institucionet lokale respektivisht DSHPIISE.

Neni 16

16.1 Ndërmarrja përgjegjëse e ka për obligim që pas lidhjes të bej testimin e rrjedhjes së ujit të pijshëm ne ndërtesë, testimin e rrjetit të kanalizimit dhe rrjetit te ujërave atmosferik.

16.2 Nëse ndërmarrja nga pika paraprake, nuk e kryen lidhjen me kërkesën e palës, atëherë institucionet lokale respektivisht drejtoria përkatëse (DSHPIISE) këto punë mund t'ia besojë individit tjetër juridik ose fizik të autorizuar për kryerjen e këtyre punëve.

Neni 17

Shpenzimet e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit dhe atmosferik, i bartin shfrytëzuesit e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 18

18.1 Ndalohet lidhja pa leje në rrjetin publik të ujësjellësit, kanalizimit dhe atmosferik

18.2 Ndalohet çdo rrëmihje pa leje paraprake për lidhje në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit dhe atmosferik. Çdo rrëmihje pa leje paraprake do të ndëshkohet sipas Dispozitave Ndëshkuese të kësaj Rregulloreje.

Neni 19

Matja e ujit të shpenzuar nga rrjeti publik i ujësjellësit, duhet të kryhet vetëm përmes ujëmatësit. Në rast të prishjes së ujëmatësit, ndërmarrja përgjegjëse do të caktojë shumën e paragjykuar (paushall) të pagesës së mesatares së tremujorit të fundit, deri sa të rregullohet ujëmatësi apo të vendoset ujëmatësi i ri.

Neni 20

20.1 Pronarët e ndërtesave me rrjet të ujësjellësit, ku shpenzimet e ujit paguhen në mënyrë të paragjykuar (paushall), janë të obliguar që në afatin prej 60 ditësh nga dita e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi, me shpenzimet e veta, ta vendosin ujëmatësin në rrjetin e vet.

20.2 Nëse shfrytëzuesi i ujit nuk e vendos ujëmatësin, ndërmarrja përgjegjëse menjëherë do ta shkyç shfrytëzuesin e ri nga ujësjellësi publik dhe do të kërkojë dëmshpërblim për ujin e konsumuar dhe për punën e shkyçjes

Neni 21

21.1 Vendosjen, respektivisht montimin e ujëmatësve dhe ndërrimin e ujëmatësve të vjetër, e bën ekskluzivisht ndërmarrja përgjegjëse dhe atë në afat brenda 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga ana e pronarit.

21.2 Vendosja e ujëmatësve të rinj dhe riparimi dhe ndërrimi i ujëmatësve të vjetër, bëhet me shpenzimet e shfrytëzuesit të ujit.

Neni 22

22.1 Ujëmatësit patjetër duhet të jenë të mbrojtur dhe të vendosur në vendet e veçanta dhe të mbyllura, të cilat ndërtohen me shpenzimet e investitorit, respektivisht të pronarit të ndërtesës, në bazë të udhëzimeve të ndërmarrjes përgjegjëse.

22.2 Ujëmatësi duhet të vendose ne vendet ku qasja është e lehtë dhe e pa penguar për verifikimin e konsumimit të ujit të pijshëm.

Neni 23

Çdo prishje dhe dëmtim të ujëmatësit, konsumatori është i obliguar që menjëherë ta paraqesë te ndërmarrja përgjegjëse dhe kjo është e obliguar që këtë prishje dhe dëmtim ta sanojë në afatin prej 24 orësh.

Neni 24

Shpenzimet e mirëmbajtjes së kyçësve në rrjetin e ujësjellësit, prej lidhjes me rrjetin e ujësjellësit të qytetit e deri te ujëmatësi, i mbulon ndërmarrja përgjegjëse të tjerat i mbulon shfrytëzuesi i ujësjellësit, kanalizimit dhe rrjetit atmosferik

Neni 25

25. 1 Shfrytëzuesit e rrjetit të ujësjellësit publik, janë të obliguar që të ndërmarrin masa me kohë, në mënyrë që instalimet brenda shtëpive të mbrohen nga prishjet, ngricat dhe të mbahen në gjendje të rregullt.

25.2 Te gjitha shpenzimet për rregullimin e prishjeve brenda ndërtesës i bartë shfrytëzuesi i ujësjellës, kanalizimit dhe rrjetit atmosferik

Neni 26

Shpenzimet e ujit paguhet sipas tarifës për 1 m³ ujë. Sasia e ujit të shpenzuar vërtetohet me anë të ujëmatësit.

Neni 27

27.1 Për shfrytëzimin e ujit dhe të shërbimeve nga rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit, shfrytëzuesi i ujësjellësit kanalizimit dhe rrjetit atmosferik të gjitha obligimet (pagesat) i kryen në ndërmarrjen përgjegjëse.

27.2 Tarifën mbi lartësinë e këtij kompensimi e cakton Zyra e rregullatorit të ujit dhe mbeturinave.

Neni 29

28.1 Ndërmarrja përgjegjëse do t'i shkyç shfrytëzuesit e ujit nga ujësjellësi publik, në rastin:

- a) Kur nuk paguhet uji i shpenzuar;
- b) Kur konsumatori paraqet shpërnguljen, ndërsa konsumatori i ri nuk e paraqet ujin e shpenzuar;
- c) Kur gjatë meremetimi rindërtimit apo rrëmihje të ndryshme bëhen dëmtimet në rrjetin e ujësjellësit;
- d) Kur instalimi i ujësjellësit i dëmton shfrytëzuesit e vet, përkatësisht cilësia e ujit në rrjetin e ujësjellësit nuk është e mirë;
- e) Kur gropa e ujësjellësit (vendi ku është bërë lidhja-ujëmatësi) është e ndotur, e mbyllur ose e prishur, ndërsa konsumatori edhe përkundër vërejtjes me shkrim nga ana e ndërmarrjes, nuk ka ndërmarrë veprime për evitimin e të metave;
- f) Kur fatura për ujin e shpenzuar nuk paguhet në afat prej 15 ditësh pas marrjes së vërejtjes me shkrim;
- g) Kur dëmtohet apo hiqet blomba nga ujëmatësi;
- h) Kur vet pronari e rregullon ujëmatësin pa e njoftuar ndërmarrjen përgjegjëse dhe
- i) në rastet e jashtëzakonshme (fatkeqësitë e ndryshme).

28.2 Kycja e serishme bëhet me kompensimin e shpenzimeve nga shfrytëzuesi i ujit në përjashtim të pikës i) të nenit 28.

Neni 29

Ndërmarrja përgjegjëse së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, nuk do të kërkojë kompensim për ujin e shpenzuar nga hidrantët publikë që harxhohen për fikjen e zjarreve.

Neni 30

Ndërmarrja përgjegjëse është e obliguar që ta pengojë çdo derdhje të paarsyeshme të ujit, në krojet publike apo humbje tjera të identifikuara.

Neni 31

31.1 Në rast të thatësisë dhe pengesave tjera të furnizimit me ujin e pijes, ndërmarrja përgjegjëse është e obliguar që të ndërmarrë masa teknike të kufizimit të shpenzimit të ujit, mirëpo paraprakisht të gjithë banorët duhet të njoftohen nëpërmes mediave të ndryshme lokale.

31.2 Në këto raste, ndërmarrja përgjegjëse nga paragrafi 31.1, iu propozojë organeve përkatëse të institucioneve lokale që me urdhëresë të veçantë, të caktojë mënyrën e shpenzimit të ujit, kufizimin ose ndalimin e shpenzimit të ujit për disa konsumatorë të caktuar. Urdhëresën e zbaton ndërmarrja përgjegjëse dhe Inspektorati komunal.

Neni 32

32.1 Përmes hidrantëve të rrjetit të ujësjellësit publik, ujin mund ta marrin vetëm ndërmarrjet dhe subjektet tjera, të cilat e kanë pëlqimin paraprak nga ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

32.2 Shërbimi publik i zjarrfikësve ka të drejtë të marrë ujin nga ujësjellësi publik gjatë intervenimit në fikjen e zjarreve.

32.3 Të gjithë konsumuesit tjerë të ndërmarrjeve apo personat fizikë, të cilët marrin sasi të caktuara të ujit për kryerjen e punëve ndërtimore e të ngjashme, patjetër duhet të kenë leje të posaçme nga ndërmarrja përgjegjëse. Shfrytëzimi i ujit nga rrjeti i hidrantëve publikë rregullohet me kontratë të posaçme, ndërmjet ndërmarrjes dhe shfrytëzuesit.

Neni 33

Kryesit e punëve (personat juridikë dhe fizikë), gjatë ndërtimit është i obliguar që rregullisht të mirëmbajë dhe ta bëjë pastrimin e përcjellësve dhe të pusetave për kanalizimin e ujërave fekale dhe atmosferike, në mënyrë që në çdo kohë të ketë rrjedhje pa pengesa.

Neni 34

Kryesit e punëve (personat juridikë dhe fizikë), menjëherë pas kryerjes së punëve ndërtimore, në afatin të cilin e ka caktuar organi kompetent me rastin e dhënies së lejes për kyçje, janë të obliguar që materialin e tepërt ta mënjanojnë nga rrugët, trotualet, sipërfaqet publike dhe terrenin ta kthejnë në gjendjen e mëparshme. Të gjitha shpenzimet i kryen investitori.

Neni 35

Gjatë shfrytëzimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndalohet:

- a) Hedhja e mbeturinave, hirit, çimentos, rërës e fundërrinave tjera të ngjashme në rrjetin shtëpiak të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të cilat mund të shkaktojnë prishjen dhe dëmtimin e funksionimit të rregullt të pajisjeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- b) Derdhja e lëndëve të ngurta dhe materialit tjetër të ngjashëm në përcjellësit e ujit të rrugëve;
- c) Hedhja e mbeturinave nga pastrimi i oborreve dhe shesheve në ujëmbledhës;
- d) Derdhja në kanalizim e ujit dhe lëngjeve të tjera, temperatura e të cilave është më e lartë se 100 C, ose me përmbajtje të thartirave të dëmshme të alkaleve dhe të kripërave;
- e) Derdhja e ujërave fundërrinore pa lejen e ndërmarrjes përgjegjëse.
- f) Hedhja e material ndezës në kanal, i cili mund të shkaktojë zjarr;
- g) Parkimi i automjeteve apo vënia e materialit ose mbeturinave në dhe mbi objektet e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- h) çfarëdo dëmtimi në objektet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

B. Hapësirat e gjelbërta publike

Neni 36

36.1 Hapësirë e gjelbër publike është toka që është pjesërisht ose plotësisht e mbuluar me bar, pemë, kaçube, ose bimësi të tjera, e qasshme për publikun si në zonën urbane, periferike dhe rurale. Hapësira e gjelbër publik mund të përfshijë:

- a) Parqe.
- b) Kopshte të komunitetit.
- c) Gjelbërimi në oborret e shkollës.
- d) Gjelbërimi brenda institucioneve lokale dhe ndërmarrjeve publike.
- e) Gjelbërimi brenda hapësirave shëndetësore.
- f) Gjelbërimi në terrenet e sportive.
- g) Gjelbërimi në hapësirat publike.
- h) Gjelbërimi në sheshet publike.
- i) Gjelbërimi përgjatë lumit.
- j) Gjelbërimi i varrezave (brenda dhe përreth saj).
- k) Gjelbërimi përreth monumenteve dhe objekteve të ndryshme kulturore.
- l) Shtigjet natyrore për ecje.
- m) Sipërfaqet e lira të gjelbra të pa zhvilluara.
- n) Rendet me drunj brenda zonës urbane dhe jashtë saj.

36.2 Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk kanë të bëjnë me pyjet, tokën bujqësore dhe pjesët e natyrës për të cilat aplikohen dispozita të veçanta.

Neni 37

37.1 Gjelbërimi i sipërfaqeve në vendet e sapondërtuara, parashihet me projektet e ndërtimeve të reja dhe bëhet me anë të kontrollit profesional të DSHPIISE dhe Drejtorisë për urbanizëm, gjeodezi dhe kadastër DUGJK.

37.2 Zgjerimi dhe ngritja e sipërfaqeve të reja, bëhet me anë të projektit për ndërtimin dhe rregullimin e hapësirave të reja të gjelbërta publike, në harmoni me planet urbane.

Neni 38

38.1 Projektet e të gjitha ndërtesave që do të ndërtohen në pjesët e territorit të komunës, në vete duhet të përfshijnë edhe planet dhe skicat për gjelbërim, të cilat sipas lokacioneve u takojnë atyre ndërtesave. Këto plane duhet të janë të dorëzuar në formë digjitale dhe në letër dhe të janë pjesë e arkivit të DSHPIISE dhe DUGJK.

38.2 Projektet të cilat nuk i kanë planet - skicat për gjelbërim, do të konsiderohen si jo të plota dhe nuk mund të miratohen ose të pajisen me lejet përkatëse.

38.3 Nëse bëhet ndërtimi në kundërshtim me pikat: 38.1 dhe 38.2 të këtij neni, DSHPIISE dhe DUGJK duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet për harmonizimin e gjendjes me dokumentacionin të dorëzuar. Kjo nënkupton se duhet të ndërpriten punët dhe të paralajmërohet investitori, ndërsa pas ndjekjes së të gjitha procedurave, investitori mund edhe të ndëshkohet.

Neni 39

Të gjitha planet – skicat e gjelbërimit, duhet të jenë të harmonizuara me planin e gjelbërimit të komunës, me planet urbane ose strategjitë tjera sektoriale të cilat kanë të bëjnë me gjelbërimin publikë për të cilat duhet të kujdeset projektuesi, respektivisht investuesi.

Neni 40

40.1 Punët rreth gjelbërimit të tërësishëm të lokacioneve, investuesit janë të detyruar t'i kryejnë para se të bëhet pranimi teknik i punëve ndërtimore dhe punëve të tjera nëpër ndërtesat investuese.

40.2 Komisioni për pranimin teknik të objekteve, është i detyruar që njëkohësisht të bëjë edhe pranimin teknik të punëve të gjelbërimit.

Neni 41

Sipërfaqet e gjelbëruara në mënyrë jo të rregullt në tokën e urbanizuar ndërtimore (me theks te veçantë për ndërtimet e objekteve shumë banesorë dhe bizneseve), shfrytëzuesi do t'i gjelbërojë në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, më së voni në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 42

Para se të bëhet gjelbërimi i sipërfaqeve të parapara me këtë Rregullore, shfrytëzuesit e tokës janë të obliguar të marrin pëlqimin e organit kompetent të Administratës.

Neni 43

43.1 Punët rreth gjelbërimit, si kultivimi i drurëve, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sipërfaqes publike dhe sipërfaqeve tjera të gjelbra, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, i kryejnë pronarët dhe ndërmarrja së cilës i besohen këto punë.

43.2 Të drejtat dhe obligimet lidhur me kryerjen e punëve nga paragrafi paraprak, do të rregullohen me kontratë.

Neni 44

Nëse shfrytëzuesit e tokës nuk e kryejnë gjelbërimin në afatin e paraparë, organi kompetent i Komunës do ta urdhërojë ndërmarrjen e cila merret me këto punë, që ta bëjë gjelbërimin me shpenzimet e shfrytëzuesit.

Neni 45

Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të gjelbërimit, është e obliguar që në të gjitha hapësirat e gjelbërta publike të vendosë dhe të mirëmbajë numër të mjaftueshëm të shportave për mbeturina të imëta dhe numër të mjaftueshëm të ulëseve për pushim.

Neni 46

Vendosja e instalimeve nëntokësore (objekteve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, elektro – shpërndarja dhe të rrjetit të telekomit e të ngjashme) në sipërfaqet e gjelbra, bëhet në distancë prej 2 m nga fidani ekzistues, por me lejen paraprake për gropim nga DSHPIISE dhe me obligimin që investuesit ta kthejnë në gjendjen e mëparshme, sipas kushteve të përshkruara në leje dhe në projekt.

Neni 47

Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit publik, është e obliguar:

- a) t'i largojë menjëherë degët e dëmtuara nga kushtet natyrore atmosferike ose nga shkaktarë të tjerë,
- b) Degët e drurëve në sipërfaqet e gjelbra publike të cilat i pengojnë kabllojt ajrore (rrjetin elektrik, kabllor, telefonik etj).

- c) Në kërkesë të pronarëve privat mund të bëjnë largimin e degëve të drurëve ne hapësirat e gjelberta publike të cilat e cenojnë pronën private, kundrejt një pagese të caktuar të ndërmarrjes përgjegjëse.
- d) ta largojë barin e kositur dhe materialin e mbetur në sipërfaqet e gjelbra publike.
- e) në rastet e caktuara të bëjnë prerjen e drunjtëve vetëm kur ato janë të thara, jo të qëndrueshme, burim i infeksioneve dhe paraqesin rrezik për shëndetin e publikut.
- f) Në rastin e prerjes së drunjtëve, ndërmarrja përgjegjëse duhet të dorëzon raportin e arsyeshmërisë dhe ta bëjë publike nëpërmjet informimit publik, mediave lokale dhe rrjeteve sociale ne afat 7 ditorë.
- g) Ti përgjigjet Institucioneve lokale në kërkesat e ndryshme rreth rregullimit të hapësirave të gjelbërta publike.
- h) Ti raporton të gjitha dëmet e hapësirave të gjelbërta publike tek institucionet lokale respektivisht në DSHPIISE.
- i) Të hartoj raportin vjetor rreth punëve ne hapësirat e gjelbërta publike dhe të bëjë propozimet e ndryshme rreth mirëmbajtjes.
- j) Të vendos informata të ndryshme ne hapësirat e gjelbërta publike.

Neni 48

Në sipërfaqet e gjelbra publike ndalohet:

- a) Prerja, këputja dhe shkujja e drurëve, e barit dhe e bimëve të tjera, thyerja e degëve apo fidanëve e të ngjashme;
- b) vozitja dhe parkimi i automjeteve (i të gjitha llojeve), si dhe shkarkimi dhe deponimi i çfarëdo materiali në këto sipërfaqe;
- c) dëmtimi i ulëseve, i shportave, i rekuizitave, i hidrantëve dhe i instalimeve tjera, dhe kalimi për këmbësorë;
- d) largimi, , dëmtimi i shenjave dhe mbishkrimeve të vendosura me qëllim të mbajtjes së rendit;
- e) Djegia e mbeturinave apo çfarëdo lloji tjetër te djegies ne hapësira të gjelbërta publike.
- f) shfrytëzimi i sipërfaqeve të gjelbra, publike dhe të tjera, jashtë destinimeve të tyre themelore, ose kryerja e çfarëdo veprimtarie në to pa lejen e veçantë;
- g) vendosja dhe derdhja e çfarëdo lënde dhe materiali tjetër nëpër drurë dhe në pjesët tjera, si dhe shkurtimi i drurëve dhe bimëve të tjera pa lejen e organit kompetent për punët komunale;
- h) rrëzimi dhe zhvendosja e ulëseve, rekuizitave sportive, rrethojave e të ngjashme;
- i) lëvizja jashtë rrugicave të shënuara për këmbësorë;
- j) lëshimi i ujërave të zeza në parqe dhe sipërfaqe tjera publike;
- k) keqpërdorimi i ujit në fontana (hyrja në to, larja e personave dhe gjësëndeve, turbullimi i ujit dhe hedhja e fundërrinave dhe mbeturinave tjera);
- l) gjuajtja përndjekja e habitatit të faunës ;
- m) kositja dhe largimi i barit nga sipërfaqet e gjelbra pa lejen e organit kompetent ;
- n) vendosja e parqeve argëtuese, cirkut dhe rekuizitave tjera pa lejen e organeve kompetente të Institucioneve lokale ;
- o) shfrytëzimi për kullosa të kafshëve dhe shpezëve shtëpiake;
- p) hedhja e shtazëve dhe shpezëve të ngordhura dhe fundërrinave të tjera;
- q) rrëmihja për çfarëdo destinimi, pa u pajisur me leje nga institucionet lokale.

C. Hapësirat publike

Neni 49

Hapësirë publike i referohet një zone ose vendi që është i hapur dhe i qasshëm për të gjithë banorët, pavarësisht nga gjinia, raca, etnia, mosha ose niveli socio-ekonomik. Këto janë hapësira për mbledhje dhe qëndrim publikë në numër të pakufizuar, të tilla si :

- a) Shëtitorët.
- b) Sheshet.
- c) Parqet.
- d) Hapësirat e gjelberta (gjelbërimi i ulët dhe gjelbërimi i mesëm).
- e) Hapësirë me drunjë (te vendosura ne një drejtim, te grumbulluara apo te përhapura ne një sipërfaqe).
- f) Hapësirat me uj (shatërvanë apo fontana).
- g) Hapësirat për rekreacion dhe terrenet sportive
- h) Hapësirat me monumente.
- i) Hapësirat përreth objekteve shume banesorë publike (përjashtim atyre private).
- j) Hapësira lidhëse, të tilla si trotuaret, rrugët, rrugica dhe shtigje te çiklistëve.
- k) Hapësirat përreth ndërtesave institucionale.
- l) Hapësirat përreth e ndërtesave edukative dhe kulturore.
- m) Hapësirat përreth e ndërtesave te ndërtesave fetare.
- n) Hapësirat e stacioneve (stacioni i autobusëve, stacioni i trenit).
- o) Parkingjet.
- p) Tregjet publike te hapura dhe te mbyllura.
- q) Varrezat.

D. Rrugët dhe trotuaret

Neni 50

Rrugët janë sipërfaqe publike, të cilat shërbejnë për qarkullimin e këmbësoreve dhe mjeteve te motorizuara.

Neni 51

51.1 Rrugët mbahen në gjendje të rregullt dhe shfrytëzohen nga akterë të ndryshëm (mjetet e motorizuara, këmbësoret apo çiklistët).

51.2 Ndërmarrja e përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, është e obliguar që t'i evitojë të gjitha dëmtimet nëpër rrugët e trafikut, trotuaret dhe shtigjet për çiklist si dhe t'i mbajë ato në gjendje të rregullt.

Neni 52

52.1 Në sipërfaqet e rrugëve të shtruara me shtresën e asfaltit, ndalohet lëvizja e të gjitha mjeteve transportuese dhe të tjera që mund ta dëmtojnë rrugën, siç janë: makinat me zinxhirë dhe llojet e ndryshme të makinave ndërtimore që përmbajnë shtresa metalike për lëvizje.

52.2 Transporti i makinave dhe i mjeteve tjera që e dëmtojnë rrugën, mund të bëhet vetëm me mjete transportuese të veçanta.

52.3 Ndalohet qarkullimi i automjeteve me peshë mbi peshën e lejuar në ato rrugë.

52.4 Ndalohet bllokimi – rezervimi me gjësende te ndryshe, i parkingut ne rruge nga personat fizik apo subjekte te biznesit.

Neni 53

53.1 Trotuaret janë sipërfaqe publike, të cilat shfrytëzohen për ecjen e këmbësorëve.

53.2 Shiriti i rrugës shfrytëzohet për lëvizjen e mjeteve të komunikacionit.

53.3 Shtigjet për çiklistë përdoren vetëm për biçikleta dhe mikromobilitetin.

Neni 54

54.1 Në sipërfaqet e trotuareve nuk lejohet shitja, vendosja e gjësendeve për zhvillimin e ndonjë veprimtari.

54.2 Ndalohet parkimi i automjeteve ne trotuare vetëm në përjashtim kur ekziston ndonjë shenjë e trafikut e cila e mundëson parkimin.

Neni 55

55.1 Shkarkimi i mallit nëpër trotuare lejohet paradite nga ora 6:00 deri ne ora 7:30 ndërsa pasdite nga ora 18:00 deri ne ora 19:00.

55.2 Njëherësh, malli duhet të largohet menjëherë nga trotuari, në përjashtim kur kemi të bëjmë me sasi te madhe te mallit atëherë më së voni në afat prej një ore pas shkarkimit të mallit paradite ndërsa pasdite nuk lejohet shkarkimi i mallit me sasi të madhe

55.3 Shkarkim i mallit për një periudhe ma të gjatë në trotuare bëhet vetëm me lejen paraprake të DSHPIISE.

Neni 56

56.1 Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, janë të obliguar që trotualet, shiritat e rrugëve dhe sipërfaqet tjera publike, t'i shfrytëzojnë në mënyrën si parashihet me këtë Rregullore.

56.2 Nëse gjatë shfrytëzimit të këtyre sipërfaqeve shkaktohet dëmtimi i tyre, shfrytëzuesit janë të obliguar që t'i kthejnë ato në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e veta.

56.3 Ndalohet vendosja e karrigeve, tavolinave, tezgave, ambalazhit, mallrave etj. në trotuare, sheshe dhe rrugë, përveç subjekteve që janë të pajisura me leje nga DSHPIISE kundrejt një pagese.

56.4 Ndalohet vendosja e vazove me gjelbrim apo gjësende tjera ne trotuare pa lejen paraprake te DSHPIISE.

Neni 57

57.1 Për ndërtimin e objekteve komunale, të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të rrjetit elektrik dhe të telefonisë, mund të lejohet gropimi i shiritit të rrugëve, trotuareve apo shtigjeve te çiklistëve.

57.2 Gropimi i trotuareve dhe shiritit të rrugëve, trotuareve apo shtigjeve te çiklistëve., nga paragrafi paraprak, mund të bëhet me lejen e DSHPIISE.

57.3 Rregullorja me të cilën lejohet gropimi i trotuareve, shiritit të rrugës, shtigjeve të çiklistëve, parkingjeve dhe të sipërfaqeve publike, përveç kushteve të tjera, përmban edhe obligimin e shfrytëzuesve, respektivisht të investitorit, që shiritin e rrugës, trotuarin apo shtigjet e çiklistëve. ti kthejnë në gjendje të mëparshme.

57.4 Pjesa e rrëmihur e rrugëve, trotuareve apo shtigjeve te çiklistëve, rimbushet me zhavorr dhe me dhe.

57.5 DSHPIISE, para dhënies së lejes për gropimin e rrugëve dhe sipërfaqeve tjera publike, do të kërkojë që investitori më parë ta paguajë taksën për gropim, e paraparë me Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Neni 58

58.1 Një parkingu publik është një hapësirë e caktuar për ndalimin e mjeteve te motorizuara për një periudhë të caktuar, e shtruar me materiale si asfalti, kubëza ose materiale tjera ekologjike të cilat janë të shenjëzuara me vija të bardha, e të cilat i e kufizojnë hapësirë për ndalimin e mjetit motorik.

58.2 Parkingjet publike mund të janë të hapura dhe të mbyllura.

58.3 Parkingjet publike të hapura mund të janë pa pagesë dhe me pagesë. Pagesa caktohet nga institucionet lokale.

58.4 Parkingjet publike të mbyllura mund të janë nëntokësore, sipërfaqësore dhe kate.

58.5 Të gjitha parkingjet publike të mbyllura janë me pagesë.

58.6 Të gjitha parkingjet e hapura publike janë të planifikuara qe mjetet motorike të përshtatet brenda hapësirës së kufizuar me vija të bardha me parkim paralel, parkim pingul ose parkim këndor.

Neni 59

59.1 Lejohet rezervimi i parkingjeve të hapura dhe të mbyllura publike për subjektet e caktuara, të cilat paraprakisht duhet te pajisen me leje nga institucionet lokale, respektivisht nga DSHPIISE kundrejt një pagese e cila caktohet në bazë ditore, javore, mujore apo vjetore.

59.2 Përjashtim nga pagesat janë institucionet publike (Policia, Agjencitë shtetërore, Gjykata etj.). Numri i vend parkimeve për institucionet publike pa pagesë caktohet nga DSHPIISE.

Neni 60

60.1 Të gjitha kompanitë e taksistëve duhet të kanë vendqëndrimin e tyre brenda zonës urbane (qendër, lagje dhe para lagje) maksimumi 1 parking për 1 kompani.

60.2 Rezervimi i pikave shtesë të vend parkimit për kompanitë e taksive mund të sigurohen kundrejt një pagese ditore, javore, mujore apo vjetore.

60.3 Pika 60.2 assesi nuk duhet ta cenon lëvizjes e trafikut, sigurinë ne trafik dhe cenimin e qasjeve te lira në ndërtesat përreth.

60.4 Pika 60.3 assesi nuk duhet ta pengon punën e ndërmarrjeve publike (ne këtë rast grumbullimi i mbeturinave), të pengon rastet emergjente (bllokimi i hidrantëve) apo të pengon transportin publik.

Neni 61

61.1 Të gjitha vend parkimet publike të hapura dhe të mbyllura duhet ti kanë të shenjzuarat vijat e çdo parkimi me ngjyrë të bardhë me dimensionet minimale 250 x 500 cm.

61.2 Të gjitha parkingjet duhet të kane të rezervuar parking për personat me aftësi të kufizuara ku për çdo 14 automjete duhet te këtë një parking për personat me aftësi të kufizuara.

61.3 Për parkingjet e rezervuara do të përdoren këto ngjyra:

- a) Parking për TAXI do të përdoren vijat e verdha
- b) Parking për institucione do të përdoren vijat e kaltërta.
- c) Për vendet rreptësisht të ndaluara për parking do të përdoren vijat e kuqe.

61.4 Të gjitha parkingjet do ti kanë të dallueshme shenjat e trafikut me informacionet rreth parkingut me pagese apo pa pagese, orarit te lejuar për parking, periudhën kohore te lejuar për parking. Parking për personat me aftësi te kufizuara etj.

61.5 Të gjitha parkingjet publike duhet te janë të ndriçuar mirë dhe ne të ardhmen të pajisen me CCTV.

Neni 62

62.1 Ndalohet uzurpimi i parkingjeve nga çdo person fizik apo subjekt tjetër pa lejen e institucioneve lokale.

62.2 Ndalohet qëndrimi i gjate ne një vend parkim (qëndrim mbi një jave) vetëm në përjashtim të posedimit të lejes nga institucionet lokale apo ne raste të ndonjë fatkeqësie (e cila duhet te dokumentohet).

62.3 Largimin e automjeteve te amortizuara behet nga institucionet lokale ne bashkëpunim me policinë dhe ndërmarrjen përgjegjëse për kryerjen e këtij veprimi.

62.4 Ndalohet shfrytëzimi i parkingjeve për aktivitete te ndryshme biznesi.

62.5 Ndalohet parkimi jo i rregull (jashtë vijave të vizatuara)

62.6 Ndalohen te gjitha parkimet e mjeteve te motorizuara jashtë zonave të identifikuar për parkim.

E. Ndrçimi publik

Neni 63

Të gjitha rrugët e qytetit, gjatë natës duhet të jenë të ndriçuara:

- a) Llambat elektrike për ndriçim publik duhet të jenë të vendosura në vendet që mundësojnë ndriçimin e tërësishëm të rrugëve, sipas normativave të përcaktuara;
- b) Llambat e djegura, brenda 24 orëve, patjetër duhet të zëvendësohen me të llamba të reja.

Neni 64

Për ndriçimin e rrugëve, ndërrimin e llambave të djegura dhe mirëmbajtjen e rrjetit ndriçues në gjendje të rregullt, kujdeset ndërmarrja përgjegjëse së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së ndriçimit publik.

Neni 65

Kryerjen e punëve në rrjetin publik elektrik dhe telefonik, e bën vetë ndërmarrja përgjegjëse dhe e specializuar për këto punë.

Neni 66

Ndalohet:

- a) thyerja, djegia ose dëmtimi i instalimit elektrik publik në ndonjë mënyrë tjetër, shtyllave, kablllove, rrjetit të telefonit, mjeteve izoluese, trafo stacioneve etj.;
- b) kryerja e punimeve në dhënien e lidhjeve për pajisjet shtëpiake, apo çfarëdo lidhje tjetër nga rrjeti i ndriçimit publik, shtyllave të instalimeve tjera, si dhe kontakti me to i personave të paautorizuar.

F. Firmat dhe reklamat

Neni 67

67.1 Të gjithë organizatat biznesi janë të obliguar që ta vendosin firmën në hapësirën punuese, në pjesën e jashtme të hyrjes kryesore të lokalit në të cilin veprojnë dhe punojnë.

67.2 Firma duhet të jetë e lexueshme

67.3 Lejohet vendosja e firmave elektrike (ndriçuese) në biznese vetëm në rastet kur ato nuk i pengojnë banorët.

67.4 Në rast se pika 68.3 paraqet shqetësim për banorët, pronari i biznesit është i detyruar që ta largon me shpenzimet e veta në të kundërtën institucionet lokale e largojnë me shpenzimet e pronarit.

67.5 Vënia e firmave, reklamave e të ngjashme nëpër muret e ndërtesave në hyrje, në rrugë dhe në qytet, në parqe e në vende të ngjashme, mund të bëhet vetëm me leje të organit kompetent të Administratës komunale.

Neni 68

68.1 Pronarët e firmave me mbishkrime ndriçuese dhe të reklamave ndriçuese, janë të obliguar që t'i mbajnë ato në gjendje të rregullt.

68.2 Mbishkrimet ndriçuese të firmave, duhet të jenë të ndriçuara gjatë natës, prej momentit të ndezjes deri në momentin e fikjes së dritave të ndriçimit publik.

68.3 Në rast transferimi ose ndalimi të punës, pronarët e hapësirave punuese janë të obliguar që ta heqin mbishkrimin e firmës në të kundërtën i largojnë institucionet lokale me shpenzimet e pronarit.

Neni 69

Në punishtet e objekteve në ndërtim e sipër të hapësirave punuese dhe në objektin, i cili ri konstruktohet ose adaptohet si punues, duhet të vendosen mbishkrimet e firmave ndriçuese sipas dokumentacionit teknik të lejuar.

Neni 70

- 70.1 Tabelat, mbishkrimet e firmave, reklamat dhe të ngjashme, mund të punohen nga qelqi, druri, llamperia, llamarina dhe materiali i ngjashëm.
- 70.2 Format dhe madhësia e tyre duhet të jenë në pajtim me formën dhe madhësinë e fasadës dhe të hyrjes në banesë, lokal etj.
- 70.3 Kontrollin inspektues e bën DSHPIISE.

Neni 71

- 71.1 Nëse DSHPIISE, vërteton se mbishkrimi i firmës nuk është vendosur, ose nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, atëherë do të marrë vendim, me të cilën do të obligohet biznesi që mbishkrimin e firmës ta vendosë në mënyrë si është e paraparë me Rregullore.
- 71.2 Nëse shfrytëzuesi nuk vepron sipas Vendimit, vendosjen e mbishkrimeve të firmave dhe evitimin e mangësive të vërtetuara, do ta bëjë organi kompetent dhe shpenzimet për këtë do t'i bartë pronari i firmës.
- 71.3 Të gjitha firmat në fasadat e ndërtesave duhet të vendosen paralel me fasadën e ndërtesës.
- 71.4 Lejohet vendosja e firmave pingul me fasadën (e ndriçuar ose e pa ndriçuar) me dimensionet 60x45 cm në lartësinë minimale 2.40 m nga kuota e trotuarit.
- 71.5 Të gjitha firmat të cilat janë të vendosura mbi dimensionet e pikës 75.4 do të largohet një muaj pas futjes në fuqi të kësaj Rregullore.

G. Ndërtesat pamja e tyre e jashtme dhe hapësirat e përbashkëta.

Neni 72

Pronarët e ndërtesave, shfrytëzuesit e ndërtesave janë të obliguar që personalisht, ose me anë të ndërmarrjes së autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës, të ndërmarrin masa gjegjëse lidhur me pastrimin dhe mënjanimin e çfarëdo dëmtimi në linjën e ujësjellësit dhe të kanalizimit në ndërtesë.

Neni 73

Nëse brenda në ndërtesë për shkak të prishjes së kanalizimit derdhen ujërat e zeza dhe ujërat fundrrinore në lokalet e përbashkëta e të ngjashme, shfrytëzuesit - pronarët e lokaleve apo ndërtesave, janë të obliguar që me shpenzimet e veta t'i evitojnë prishjet në rrjetin e kanalizimit e të ujësjellësit.

Neni 74

- 74.1 Pamja e jashtme e ndërtesës (fasada, ballkoni, dyert, dritaret etj. pa marrë parasysh destinimin e tyre, shfrytëzimin apo pronësinë), pa tjetër duhet të mirëmbahet në pajtim me kërkesat estetike dhe pamjen e ndërtesës, ndërsa kushtet do t'i përcaktojë Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- 74.2 Pronarët e ndërtesave dhe shfrytëzuesit, janë të obliguar t'i mirëmbajnë fasadat dhe detajet e fasadave (ballkonet, tarracat, zdrukthëtaritë, ulluqet, tabelat dhe numrat e shtëpive e të ngjashme), ngjyrosjen, emalimin, në mënyrë që gjithmonë të jenë në gjendje të rregullt dhe ta kenë pamjen estetike.
- 74.3 Për pastërtinë dhe rregullimin e brendshëm të ndërtesës nga paragrafi paraprak, janë të obliguar të kujdesen shfrytëzuesit e banesave dhe shfrytëzuesit e tjerë të hapësirave, në pajtim me dispozitat e rendit shtëpiak dhe të ndërtesave banesore, ndërsa për rregullimin dhe pastërtinë e pjesëve të jashtme të ndërtesave tjera, do të kujdesen shfrytëzuesit e hapësirave, ndërmarrja e cila drejton dhe mirëmbajnë ndërtesën dhe pronarët e ndërtesës.

Neni 75

- 75.1 Oborret e ndërtesave dhe të lokaleve, duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt.

75.2 Për pastrimin e oborreve të ndërtesave të banimit e të punës, kujdesen Këshilli i banorëve, bizneset (nëse ato ekzistojnë) dhe shfrytëzuesit e oborreve.

Neni 76

Pronarët e ndërtesave, respektivisht shfrytëzuesit e sipërfaqeve të pa ndërtuara dhe qiraxhinjtë e hapësirave afariste, janë të obliguar t'i pastrojnë ndërtesat dhe sipërfaqet rreth ndërtesave, respektivisht të sipërfaqet e pa ndërtuara të cilat i shfrytëzojnë ata.

Neni 77

77.1 Ndalohet hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta: korridore, shkallë, ashensorë etj.

77.2 Ndalohet lëshimi i ujit dhe të ngjashme për larjen e ballkoneve, me qëllim të mos pengimit të fqinjët apo të tjerëve.

77.3 Ndalohet lirimimi i tymit, avullit, kundërmimit të rëndë (erërave të këqija dhe dëmshme), gazrave toksike etj., nga ndërtesat, lokalet e punës, tymtarët, gjeneratorët etj. në afërsi të ndërtesave shume banesorë dhe individual të banimit dhe atyre afariste, veçanërisht në afërsi të ballkoneve, fasadave, dritareve, tarracave dhe hyrjeve në korridore e në shkallë.

Neni 78

78.1 DSHPIISE, me vendim mund t'i urdhërojë personat përgjegjës për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të rregullsisë së pjesëve të ndërtesave, që t'i eliminojnë menjëherë mangësitë apo në afat të caktuar.

78.2 Nëse obliguesi nuk vepron sipas vendimit, ndaj tij ushtrohet kërkesë kundërvajtësi.

Neni 79

79.1 Ndërtesat dhe objektet tjera, të cilat nuk mund të shërbejnë për destinimin e paraparë dhe japin një pamje jo të mirë, për shkak se janë vjetruar dhe mund të rrezikojnë ose paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për trafik ose objektet fqinje, duhet të rrënohen ose të mënjanohen.

79.2 Vendimin për rrënim, respektivisht mënjanim, e merr DSHPIISE në bashkëpunim me DUGJK.

H. Vitrinat

Neni 80

Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve të saponërtuara afariste ose të ndërtesave banesore me hapësira afariste, të cilat janë paraparë për shfrytëzim për nevojat vetjake ose për dhënie të tyre me qira, janë të obliguar që vitrinat, para fillimit të përdorimit, të bëhen ashtu si parashihet me projektin e ndërtesës.

Neni 81

81.1 Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste në qytet dhe në para lagje të e qytetit, janë të obliguar që vitrinat t'i rregullojnë në mënyrë estetike dhe profesionale.

81.2 Lëndët të cilat shërbejnë për ekspozim, duhet të jenë të pastra dhe të pa dëmtuara dhe çmimet e shkruara me material të njëjtë në të gjithë artikujt.

81.3 Nëpër vitrina mund të vendosen reklamat e prodhimeve dhe shërbimet e shfrytëzuesve, ose të ndërmarrjeve me të cilët shfrytëzuesi është në lidhje afariste.

81.4 Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste dhe pronarët e tyre, janë të obliguar të vendosin orarin e punës.

81.5 Mbishkrimi vendoset në derën hyrëse të hapësirës afariste, shitores-lokalit, në pjesën e brendshme.

Neni 82

82.1 Shfrytëzuesit janë të obliguar t'i mbajnë pastër dhe në gjendje të rregullt vitrinat e hapësirave afariste.

82.2 Në rast të zhvillimit të punëve në adaptimin, rikonstruktimin, regjistrimin e të ngjashme, vitrinat duhet të jenë të mbuluara mënyrën më të përshtatshme nga shikimi i kalimtarëve.

Neni 83

83.1 Pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e ndërtesave afariste dhe të hapësirave afariste në qytet dhe në para lagje të e qytetit, janë të obliguar t'i adaptojnë vitrinat e vjetruara, të cilat e shëmtojnë pamjen e ndërtesës.

83.2 DSHPIISE vërteton vjetërsinë e vitrinës dhe përcakton mënyrën e adaptimit të hapësirës afariste nga paragrafi paraprak, respektivisht e obligon shfrytëzuesin e hapësirës në lidhje me adaptimin e vitrinës.

83.3 Lejen për adaptimin e vitrinës e lëshon DUGJK.

83.4 Vitrinat, skarat etj. të nxjerra jashtë murit të lokalit dhe në trotuar, të cilat i pengojnë kalimtarët, duhet të tërhiqen në afat prej 1 muaji, nga dita e miratimit të kësaj Rregulloreje. Pas kalimit të këtij afati, inspektori jep urdhër me shkrim për largim. Nëse prapë nuk bëhet largimi, atëherë nxjerr aktvendim për mbylljen e lokalit dhe, me shpenzime të pronarit, angazhon ndërmarrjen përkatëse për largimin e pengesës në trotuar - rrugë.

I. Rrethojat

Neni 84

Të gjitha rrethojat në sipërfaqe publike, pa marrë parasysh pronësinë, mund të ndërtohen vetëm në bazë të pëlqimit në lokacion të organit kompetent.

Neni 85

85.1 Pronarët e rrethojave të vjetra, janë të detyruar t'i mënjanojnë ato në afatin prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, dhe në vend të tyre të vendosin rrethojat e tipit të caktuar, sipas pëlqimit të DUGJK.

85.2 Nëse ndërtimi i paraparë i rrethojës së tipizuar kërkon mjete më të mëdha materiale, organi i DUGJK, mundet përkohësisht të lejojë që në vend të rrethojës së tipizuar, të vihen rrethojat prej druri të gjelbër, por ato duhet të mirëmbahen deri në vendosjen e tipit gjegjës të rrethojës.

85.3 Të gjitha rrethojat, duke i përfshirë edhe rrethojat e gjelbra, duhet të mirëmbahen në gjendjen e paraparë, në mënyrë që të mos prishet pamja e përgjithshme e asaj pjese të qytetit.

Neni 86

Rrethojat e gjelbra duhet të mirëmbahen, në mënyrë që të mos kalojnë vijën e rregulluese dhe të mos pengojnë lëvizjen. Deri të kryhet forma përfundimtare e rrethojës së gjelbër, si mbrojtëse mund të shfrytëzohet rrethoja ekzistuese.

J. Panot dhe tabelat e shpalljeve

Neni 87

87.1 Të gjitha llojet e shpalljeve, lajmërimeve, pllakateve, reklamave të gjitha llojeve, përveç vitrinave të teatrove dhe të kinemave, mundet të vendosen vetëm në vendet e caktuara (panot).

87.2 DSHPIISE dhe në bashkëpunim me DUGJK cakton numrin dhe vendin e panove dhe tabelat e shpalljeve, me kërkesën e personave juridikë – fizikë.

87.3 Për mirëmbajtjen e panove dhe tabelave të shpalljeve kujdesen institucionet lokale..

87.4 Për shpalljet më të vogla dhe lajmërimet për anëtarë të organizatave të ndryshme politike, kulturore dhe organizatave sportive, mund të vendosen vitrinat e vogla ose tabelat e shpalljeve (të

përkohshme) në vendet e përshtatshme, në afërsi të hapësirave vepruese ose afariste të atyre organizatave.

87.5 Vendosja sipas pikës 87.4 bëhet vetëm me pëlqimin e DSHPIISE.

87.6 Vitrinat, qoftë edhe vitrinat e vogla, nuk mund të vendosen nëpër fasada të hapësirave afariste, shtylla, ndërtesa banesore dhe vende të tjera publike.

87.7 Ndalohet:

- a) publikimi i të gjitha llojeve të shpalljeve, pllakateve e të ngjashme, si dhe vendosja nëpër mure dhe fasada, shtylla elektrike, shtëpiza të transformatorëve, shenja të komunikacionit e të ngjashme;
- b) vendosja e panove reklamave tabelave të shpalljeve nga ana e organizatave dhe qytetarëve, pa pëlqimin e DSHPIISE ;
- c) vendosja e përkohshme e panove reklamuese dhe tabelave të shpalljeve në vendet publike.
- d) Vendosja e panove dhe tabelave të shpalljes me përmbajtje të pa përshtatshme për të gjithë banorët pa përjashtim të moshës, gjinisë, etnisë, religjionit apo gjendej ekonomike.

K. Gropat dhe pusetat në rrugë

Neni 88

88.1 Për sigurimin e kalimtarëve dhe të trafikut:

- a) të gjitha gropat dhe pusetat e të ngjashme, në rrugë, sheshe, oborre, bodrume, korridore dhe në vendet e ngjashme, duhet të jenë të mbyllura;
- b) pusetat për ujësjellës dhe kanalizim, për kabllot elektrike dhe të telefonisë e të ngjashme, gjithnjë duhet të ndërtohen dhe të mbahen në gjendje të rregullt.

88.2 Për mirëmbajtjen e gropave, pusetave etj. nga paragrafi paraprak, pika a, janë të obliguar që të kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme të cilëve iu shërbejnë, ndërsa për gropat nga pika b e këtij neni, janë të obliguara të kujdesen ndërmarrjet të cilat e ushtrojnë atë veprimtari.

Neni 89

89.1 Gropat dhe pusetat e të ngjashme të përfshira në këtë Rregullore, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të mbahen të mbyllura me mbulesë adekuate të sigurt.

89.2. Gjatë kohës së përdorimit, gropat patjetër duhet të rrethohen dhe të shënohen me shenjë që shihet mirë dhe, sipas nevojës, të mbyllen mirë, në mënyrë që të mos e pengojnë sigurimin e kalimtarëve ose të trafikut.

L. Terrenet sportive

Neni 90

Terrenet dhe fushat e sportit janë sipërfaqe të lira publike, ku mbahen aktivitete sportive me qëllim të organizimit të garave dhe të argëtimit.

Neni 91

Terrenet sportive janë:

- a) Të hapura për shfrytëzim nga banorët për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive,
- b) Të mbyllura për shfrytëzim pa marrjen e lejes nga institucionet lokale respektivisht nga drejtoria e përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive (siç janë palestrat sportive dhe stadiumi në të ardhmen).

Neni 92

Ndalohet:

- a. Përdorimi i terreneve sportive të hapura për aktivitete tjera jashtë aktiviteteve sportive, në përjashtim kur sigurohet leja nga institucionet lokale respektivisht drejtoria përgjegjëse.
- b. Dëmtimi i objekteve të terreneve sportive të hapura.
- c. Kapërcimi i rrethojave të terreneve sportive të mbyllura (stadiumi në të ardhmen).
- d. Hipja ose mbështetja në rrethojat e terreneve sportive dhe të qendrave sportive dhe rekreative;
- e. Të gjitha veprimet tjera me të cilat dëmtohen terrenet sportive të hapura dhe të mbyllura.

Neni 93

93.1 Terrenet për sportive të hapura dhe të mbyllura duhet të mirëmbahen dhe të pastrohen rregullisht, për të cilat kujdesen organet, personat juridikë dhe individë, të cilët këto objekte i shfrytëzojnë dhe i mirëmbajnë.

93.2 Në hapësirat dhe objektet nga paragrafi paraprak, duhet të vendosin në vend të dukshëm, në formë të shkruar, udhëzimet higjienike dhe teknike mbi punë në këto hapësira dhe terrene.

93.3 Vizitorët janë të obliguar që t'u përmbahen udhëzimeve dhe dispozitave nga paragrafi paraprak.

M. Shënimi i rrugëve dhe i ndërtesave

Neni 94

94.1 Të gjitha rrugët duhet të kenë të shënuar, në këndet e tyre, tabelat me emërtimin e rrugëve, ndërsa ndërtesat dhe shtëpitë duhet të kenë numrat e tyre.

94.2 Shënimet me emërtimin e rrugëve dhe të shesheve, si dhe shënimet e ndërtesave dhe të trojeve, bëhen nga ana e organit kompetent.

94.3 Komuna i mbulon shpenzimet e punimit dhe të vendosjes së tabelave me mbishkrimet e rrugëve.

Neni 95

DSHPPISE mban evidencën për rrugët, emërtimin e tyre dhe numrat e shtëpive, dhe kryen me kohë ndërrimin e evidencave të nevojshme.

Neni 96

DSHPPISE përcakton formën, madhësinë dhe ngjyrën e tabelave për shënimin dhe emërtimin e rrugëve dhe të shesheve, të tabelave me numër të shtëpive, mënyrën e shënimit dhe afatin e vendosjes së tyre. Drejtoria për këtë mban evidencën në pajtim me nenin paraprak.

N. Objektet publike dhe higjienike

Neni 97

Të gjitha ndërtesat, objektet hoteliere (hotelet, motelet, autokampet) objektet për mbarëvajtjen e shfaqjeve, ligjëratave, hapësirat e klubeve, stacionet e autobusëve, stacionet hekurudhore dhe objektet tjera të ngjashme, patjetër duhet të kenë të ndërtuara më shumë nyja sanitare, në pajtim me dispozitat dhe kushtet higjienike-teknike.

Neni 98

98.1 Nyjat sanitare në ndërtesat e kinemave, teatrove, lokaleve të klubeve, stacioneve hekurudhore, objektet hoteliere, punëtori me prodhime jetësore-ushqimore, terrene sportive dhe nyjat sanitare në vendet tjera publike, duhet të jenë të gëlqerosura dhe këtë duhet bërë çdo 30 ditë, nëse nuk janë të ngjyrosura me ngjyra të yndyrshme ose nuk janë me pllaka qeramike ose prej materialit të ngjashëm.

98.2 Dezinsektimi i nyjave sanitare në objektet hoteliere, kinema, spitale dhe i nyjave sanitare publike, bëhet për çdo ditë, ndërsa në objektet tjera çdo 7 ditë.

98.3 Gjatë sezonit të verës nyjat sanitare sipas paragrafit paraprak, duhet të spërkaten me mjete dezinfektuese çdo 7 ditë.

Neni 99

99.1 Gropat septike duhet të gjenden jashtë ndërtesave dhe duhet të jenë të larguara së paku 2 m nga muri i jashtëm i ndërtesës dhe ndërtesës fqinje.

99.2 Gropat septike mund të ndërtohen nga çimentoja, guri ose tullat, dhe patjetër duhet të jenë të lyera me llaç çimentoje dhe të izoluara.

99.3 Gropat pa tjetër duhet të jenë të mbyllura hermetikisht, me pllakë betoni, guri ose metali.

99.4 Gropat septike nuk mund të ndërtohen në trotuare dhe në sipërfaqe tjera publike.

99.5 Lejen për ndërtim e jep Drejtoria e urbanizmit, në bazë të pëlqimit të inspektorit sanitar.

Neni 100

Organi i Administratës për punët e inspektimit, mund të caktojë me vendim mënjanimin e njëjës sanitare dhe të gropës septike dhe të japë urdhër që të ndërtohet e reja, nëse ajo nuk është ndërtuar sipas kushteve të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje, sepse mund të paraqesë rrezik për rrethinën në pikëpamje shëndetësore-higjienike.

O. Gropimi i sipërfaqeve publike

Neni 101

101.1 Ndalohet çdo gropim dhe çdo dëmtim në sipërfaqeve publike, me përjashtim të rasteve të parapara me këtë Rregullore.

101.2 Qytetarët dhe personat civilë – juridikë, nuk mund të bëjnë gropim e sipërfaqeve publike.

101.3 Sipërfaqet mund të gropohen në bazë të lejes së organit kompetent administrativ, me rastin e vendosjes së rrjetit të ri të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrjetit telegrafik, të objekteve të sinjalizimit në trafik, pastaj lidhur me ndërlidhjen e ndërtesave dhe objekteve të tjera për këto rrjete, si dhe për mirëmbajtjen e instalimeve të këtyre objekteve (në tekstin e mëtejme pajisjet komunale).

Neni 102

102.1 Sipërfaqet publike, me lejen e organit kompetent, mund të rrëmihen edhe për vendosjen e objekteve të përhershme ose të përkohshme, siç janë: shtyllat, panot, reklamat, tabelat e shpalljeve e të ngjashme.

102.2 Objektet nga paragrafi paraprak, mund të mbesin edhe pas skadimit të afatit për të cilin janë vendosur, nëse ato shërbejnë për zbulimin e qytetit dhe nëse merret leja nga organi kompetent i Administratës komunale.

Neni 103

Sipërfaqet e grupuara publike menjëherë duhet të merremetohen dhe të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Neni 104

104.1 Evitimi i prishjeve në pajisjet komunale dhe gropimi i sipërfaqeve publike, mund të bëhen nga ana e ndërmarrjeve të cilat kujdesen për këto pajisje, vetëm në rastet kur ndodhin prishjet dhe duhet urgjentisht të evitohen.

104.2 Në raste të tilla, ndërmarrja e cila e ka bërë gropimin është e obliguar që në ditën vijuese, ta njoftojë organin komunal kompetent për gropimin e sipërfaqes publike dhe njëkohësisht të kërkojë lejen për gropim.

104.3 Nëse organi kompetent vlerëson se evitimi i prishjes, nga paragrafi 104.1 i këtij neni, nuk ka qenë i natyrës urgjente, konsiderohet se punët e kryera janë bërë pa leje dhe kryesi i punëve i bart të gjitha konsekuencat.

Neni 105

Gropimin e sipërfaqeve publike, në perimetër prej 1 m për vënien e objekteve nga neni 100 i kësaj Rregulloreje, mund ta bëjë edhe organizata që i vendos ato objekte, ndërsa meremetimin e kryen vet ose nga ndërmarrja për mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Neni 106

106.1 Kërkesa për dhënien e lejes për gropimin e sipërfaqeve publike, duhet t'i përmbajë shënimet mbi llojin dhe sipërfaqen e bazës (shtresës), e cila duhet të rrëmihet, qëllimin e gropimit dhe vendin e saktë ku do të bëhet gropimi, koha, fillimi dhe përfundimi i punëve etj.

106.2 Kërkesës duhet bashkëngjitur edhe situata (skica) e terrenit, në shkallën 1:500 me terrenin e vizatuar dhe sipërfaqen për gropim, dhe me pozitën e pajisjeve komunale në krahasim me pikat markante (të poshtme), si dhe thellësinë e gropimit.

Neni 107

107.1 Lejen për gropimin e sipërfaqeve publike e jep organi kompetent për punë komunale.

107.2 Organi nga paragrafi paraprak, nuk mund ta japë lejen për gropim e sipërfaqeve publike në periudhën kohore prej 1 dhjetori deri më 28 shkurt.

107.3 Në rastet e nevojave urgjente, me përjashtim, mund të lejohet gropimi në periudhën kohore prej 1 dhjetorit deri më 28 shkurt.

107.4 Në vendimin për lejimin e gropimit, pa tjetër duhet të shënohet koha e fillimit të gropimit dhe e përfundimit të punëve në meremetimin e sipërfaqeve të grupuara.

107.5 Nëse punët nuk mund të kryhen në afatin e caktuar për shkak të gropimit të sipërfaqes publike, investuesi është i obliguar që të kërkojë nga organi kompetent vazhdimin e punimeve.

Neni 108

108.1 Gjatë gropimit të sipërfaqeve publike, patjetër duhet të sigurohet vendi i paraparë për ndërtim, në mënyrë të theksuar me shenja, rrethojë dhe masa tjera mbrojtëse, në pajtim me dispozitat mbrojtëse në ndërtimtari.

108.2 Kryesi i punëve veçanërisht është i obliguar që:

- a) gropimin ta kryejë sipas lejes së dhënë;
- b) vendi i paraparë për ndërtim të jetë i ndriçuar gjatë natës;
- c) vendin për ndërtim ta rregullojë në mënyrë që të mundësohet qarkullimi i automjeteve dhe i këmbësorëve pa pengesë;
- d) të shënohet dhe gjatë natës të ndriçohet vendi ku është lejuar, respektivisht ndaluar kalimi i automjeteve dhe këmbësorëve;
- e) punët të kryhen në pajtim me të gjitha kushtet teknike, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve dhe të shesheve.

108.3 Pas kryerjes së punëve, vendi në të cilin është punuar duhet të kthehet në gjendje të rregullt paraprake dhe të largohen të gjitha materialet nga vendi ku është bërë ndërtimi.

108.4 Rruga për trafik, në raste të veçanta, mund të groposet në tërë gjatësinë e saj, nëse nuk mund të kryhen punët në mënyrë tjetër, gjatë natës, në kohë prej orës 22:00 deri në orën 4:00 të ditës në vijim.

Neni 109

109.1 Baza e grupuar (sipërfaqja) duhet të kthehet në gjendje të mëparshme, në mënyrën dhe afatin që është caktuar në aktvendimin e lejes për gropim.

109.2 Sipërfaqja e ndërtuar publike, nuk guxon të shfrytëzohet pa lejen e organit kompetent.

Neni 110

Nëse bëhet gropimi i trotuarit, kryesi i punëve është i obliguar që me mjete përkatëse, të sigurojë kalimin mbi pjesën e propozur të rrugës.

Neni 111

Kryesi i punëve është i obliguar që të sigurojë qasje pa pengesë në ndërtesat afariste dhe në lokale, si dhe në ndërtesat banesore e objektet tjera.

Neni 112

112.1 Gjatë ndërtimit të rrugëve të reja ose rikonstruktimit të rrugëve ekzistuese, ndërmarrjet për mirëmbajtjen dhe qeverisjen e pajisjeve komunale, si dhe qytetarët dhe organizatat, të cilat në ato rrugë posedojnë objekte, duhet të jenë të njoftuara së paku 15 ditë para fillimit të ndërtimit ose rikonstruktimit, në mënyrë që të përgatitet për vendosjen e pajisjeve komunale ose për lidhjen e objekteve të veta me këto pajisje.

112.2 Qytetarët dhe subjektet tjera me të cilat kanë të bëjnë dispozitat e paragrafit paraprak, janë të obliguara që mbi nevojat e kryerjes së punëve në pajisjet komunale dhe në lidhjet, të njëjtit ta njoftojnë investitorin i cili punon ose rikonstruktin rrugën, në mënyrë që vendosja e lidhjeve të bëhet para ndërtimit ose rikonstruktimit të rrugës.

112.3 Rrugët e projektuara dhe të rikonstruktuar, nuk mund të groposen para 3 vjetëve nga mbarimi i ndërtimit ose rikonstruktimit, përveç në raste të parapara me këtë Rregullore.

Neni 113

113.1 Investuesi është i obliguar që, para marrjes së lejes për rikonstruktimin e sipërfaqeve publike, ta deponojë depozitën bankare, në pajtim me rregullat e prokurimit, për evitimin e lëshimeve eventuale dhe meremetimin e sipërfaqeve publike.

113.2 Para marrjes së lejes për rikonstruktimin e sipërfaqeve publike, investuesi është i obliguar që të sigurojë nga kryesi i punës, garancinë për cilësinë e punëve të kryera.

Neni 114

114.1 Nëse paraqiten dëmtime në afatin garantues prej 1 viti nga dita e kryerjes së punimeve në sipërfaqet e grupuara, meremetimin e bart investitori me shpenzimet e veta.

114.2 Nëse investitori nuk i kryen meremetimet në bazë të paragrafit paraprak, ato i kryen organi i administratës që ka lëshuar lejen, por në barrën e tij.

P. Pastrimi i qytetit

Neni 115

Në interes të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurimit të kushteve higjienike në qytet dhe në para lagjet, rrugët, parqet, çerdhet e fëmijëve, oborret e ndërtesave familjare dhe afariste, trojet e lira dhe sipërfaqet tjera të hapura dhe të gjitha hapësirat e përbashkëta, duhet patjetër të mirëmbahen në gjendje të pastër sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 116

Për mirëmbajtjen e pastërtisë janë të obliguar të kujdesen qytetarët, ndërmarrjet, institucionet, organizatat, etj.

Neni 117

Mbajtja e pastërtisë në kuptim të dispozitave të kësaj Rregulloreje, parashihet për:

- a) Rrugët, trotualet dhe sheshet,
- b) Të gjitha hapësirat e gjelbëra publike

- c) Stacionet e autobusëve dhe vendqëndrimet e autobusëve në vijat urbane dhe ndër urbanë,
- d) Ambulancat, spitalet, çerdhet e fëmijëve dhe institucionet tjera,
- e) Stacionet hekurudhore,
- f) Varrezat,
- a) tregjet,
- b) shtrati i lumit,
- c) hapësirat e hapura dhe të zbrazëta ndërmjet banesave dhe rreth tyre, si dhe toka ndërtimore e pa ndërtuar (trojet e zbrazëta).

Neni 118

118.1 Për mbajtjen e pastërtisë në stacionet e autobusëve, të karburanteve dhe në objektet hoteliere, auto kampet dhe në vendet e ngjashme, janë përgjegjëse ndërmarrjet punuese dhe subjektet, të cilat e kanë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre objekteve.

118.2 Shfrytëzuesit nga paragrafi 119.1 i kësaj Rregulloreje, janë të obliguar që në peronat, sallat e pritjes dhe në vendet tjera ku frekuentojnë njerëzit, në vendet e përshtatshme, të vendosin numër të mjaftueshëm të shportave për hedhjen e mbeturinave.

118.3 Nyjat sanitare publike duhet mbajtur në gjendje të rregullt dhe të pajisura me mjete të nevojshme, si dhe të dezinfektohen kohë pas kohe me mjete përkatëse.

118.4 Nyjat sanitare publike pa tjetër duhet të jenë të hapura çdo ditë, prej orës 5:00 deri në ora 24:00.

Neni 119

119.1 Për mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqe publike, janë të obliguar të kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e këtyre sipërfaqeve.

119.2 Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike, punët mund t'ia besojnë ndërmarrjes së specializuar për mbajtjen e pastërtisë.

Neni 120

120.1 Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike, janë të obliguar që ta mbajnë pastërtinë në nivelin e kënaqshëm.

120.2 Pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore, të hapësirave afariste dhe trojeve të zbrazëta, janë të obliguar t'i pastrojnë trotuarët dhe sipërfaqet e tyre rreth ndërtesave, para trojeve.

120.3 Organi i administratës kompetent për punë komunale, para dhënies së lejes për shfrytëzimin e sipërfaqeve të lira publike (cirqeve, organizatave të ndryshme), do të sigurojë dëshminë mbi taksën e paguar.

Neni 121

Të gjithë pronarët e kafshëve shtëpiake janë të detyruar:

- a) Të kujdesen për sigurinë të banorëve tjerë nga kafshët e tyre shtëpiake.
- b) Të mos i shqetësojnë banorët tjerë nga zhurma e kafshëve shtëpiake.
- c) Të kujdesen në maksimum për higjienën ku ata banojnë e me theks të veçantë në ndërtesat shumë banesorë.
- d) Të kujdesen në maksimum për higjienën ku ata e shëtisin kafshën shtëpiake e sidomos të kujdesen për largimin e mbetjeve fiziologjike të kafshëve shtëpiake.
- e) Mos plotësimi i pikave të lartpërmendura do të ndëshkohen sipas dispozitave ndëshkuese të kësaj Rregullores.

Neni 122

Të gjitha oborret dhe korridoret e ndërtesave banesore, duhet të jenë në gjendje të rregullt dhe të pastër. Për mirëmbajtjen e oborreve dhe korridoreve të ndërtesave banesore kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e atyre oborreve, korridoreve dhe bodrumeve.

Neni 123

Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të obliguar që:

- a) xhamat në dritare dhe vitrina, të kenë gjithmonë të pastër dhe të rregullt;
- b) të mirëmbajnë pastërtinë e trotuarit prej lokalit deri te rruga për komunikacion dhe
- c) te largojnë borën dhe akullin nga trotuari gjatë sezonit të dimrit.

Neni 124

124.1 Banorët e qytetit dhe të periferive të qytetit, janë të obliguar t'i pastrojnë trotuaret, respektivisht pjesët e rrugëve para shtëpive të tyre, oborret dhe sipërfaqet tjera përpara dhe rreth shtëpive.

124.2 Ndalohet:

- a) hedhja e mbeturinave dhe materialit tjetër fundërrinor në shtretërit e përrrenjve, në rrugë dhe në sipërfaqe tjera publike;
- b) hedhja e plehut të kafshëve në sipërfaqet jashtë oborreve të tyre;
- c) dalja në rrugë e kanaleve përcjellëse të ujit fundërrinor dhe të fekaleve, në sipërfaqe të lira publike dhe në oborret e huaja;
- d) mbyllja e kanaleve përcjellëse nëpër rrugët e rendit të katërt dhe dëmtimet e ndryshme të këtyre pajisjeve;

Neni 125

125.1 Pastrimi i rrugëve duhet të bëhet sipas mënyrës që siguron efektin më të mirë të pastrimit dhe duke mos penguar qarkullimin e qytetarëve dhe zhvillimin normal të trafikut.

125.2. Ndalohet pastrimi i rrugëve gjatë periudhës kohore 7:00 - 23:00, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 126

126.1 Të gjitha automjetet tjera tërheqëse para se të hyjnë në sipërfaqet publike të trafikut publik, patjetër duhet të pastrohen nga balta dhe mbeturinat tjera.

126.2 Të gjitha mjetet bartëse para daljes në trafik publik, patjetër duhet të pastrohen nga balta dhe papastërtia e shkaktuar nga shkarkimet gjatë punës në objektet ndërtimore dhe nga hapësirat tjera, nga të cilat balta dhe papastërtitë tjera mund të barten në sipërfaqe publike.

Neni 127

127.1 Mjetet (qerret) tërheqëse mund të qëndrojnë vetëm në vendin e caktuar për atë qëllim nga ndërmarrja publike që kujdeset për pastërtinë e qytetit, në bashkëpunim me organet komunale.

127.2 Për mbajtjen e pastërtisë në vendet sipas paragrafit paraprak, pronarët e mjeteve tërheqëse ia paguajnë kompensimin ndërmarrjes që kujdeset për mbajtjen e pastërtisë në këto vende. Ndalja dhe parkimi i qerreve tërheqëse në trotuar, sheshe dhe rrugë, është i ndaluar rreptësishtë.

Neni 128

128.1 Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendoset numër i mjaftueshëm i shportave të mbeturina, të cilat i sigurojnë shfrytëzuesit.

128.2 Për vendosjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shportave, kujdeset ndërmarrja për mirëmbajtjen e higjienës publike.

128.3 Mënyrën vendin dhe numrin e kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe tjera publike, e cakton organi përkatës i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me kompaninë e caktuar për mirëmbajtje dhe pastrim.

Neni 129

Bartja e mbeturinave bëhet gjatë ditës në orën 18:00 dhe gjatë natës respektivisht në orën 23:00. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten, patjetër duhet të jenë të mbyllura ose të mbuluara, në mënyrë që të pengohet derdhja e tyre gjatë transportit deri në depon e caktuar.

Neni 130

130.1 Mbledhja e mbeturinave nga hapësirat banesore e afariste, bëhet me anë të enëve speciale.

130.2 Vendi dhe mënyra e vendosjes së enëve speciale caktohet nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në bashkëpunim me kompaninë e caktuar për mirëmbajtje dhe pastrim.

Neni 131

131.1 Ndërmarrja dhe qytetarët, me shpenzimet e veta, janë të obliguar të sigurojnë numër përkatës të mjeteve, enëve speciale për mbledhjen e mbeturinave nga hapësira e tyre punuese dhe sipërfaqet e lira.

131.2 Sigurimin e enëve-mjeteve speciale të parapara me këtë Rregullore, obliguesit janë të detyruar që ta bëjnë në afat prej 1 muaji nga dita e hyrjes së saj në fuqi.

Neni 132

132.1 Mbeturinat dhe fundërrinat transportohen dhe gropohen në vendin e paraparë për këtë destinim (depo), ndërsa fekalet transportohen në vendin e caktuar për to.

132.2 Deponimin dhe vendin e derdhjes së fekaleve e cakton Drejtoria e Shërbimeve Publike, me mendimin paraprak nga Inspektorati sanitar.

132.3 Për rregullimin e depos, të vendit për derdhjen e fekaleve dhe mirëmbajtjen e tyre, kujdeset ndërmarrja së cilës i besohen punët e pastrimit të qytetit.

132.4 Vendet në të cilat vendosen fekalet, patjetër duhet të jenë të rregulluara në atë mënyrë që fekalet të mos derdhen dhe të mos shpërndahen nga era.

Neni 133

133.1 Bartjen e mbeturinave nga enët e caktuara për mbeturina (enët speciale dhe kontejnerët), e kryen ndërmarrja së cilës i besohen punët e pastrimit.

133.2 Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e higjienës së qytetit, është e obliguar t'i përmbahet plan programit të miratuar për pastrimin e qytetit.

133.3 Për çdo ndryshim në lidhje me planin dhe programin e pastrimit, ndërmarrja është e obliguar që t'i lajmërojë me kohë organet gjegjëse për inspektim, respektivisht DSHPIISE .

133.4 Tarifën për lartësinë e kompensimit për bartjen e mbeturinave e cakton Zyra e rregullatorit për ujë dhe mbeturina.

Neni 134

134.1 Ndërtesat duhet të kenë nyjat sanitare - higjienike. Nëse ato mungojnë në objekte, atëherë pronarët e ndërtesave janë të obliguar që, në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, t'i ndërtojnë nyjat përkatëse sanitare - higjienike.

134.2 Ndërtimi i nyjave sanitare higjienike dhe të gropave septike, mund të bëhet vetëm në vende të përshtatshme. Vendet ku ndërtohen ato caktohen nga ana e inspektorit dhe organit kompetent për punë komunale.

Neni 135

Heqja e fekaleve nga gropat septike, nyjat sanitare dhe të ngjashme, bëhet me anë të cisternave septike, sipas rregullit të paraparë, gjatë natës, nga ora 21:00 deri në orën 5:00 të mëngjesit.

Neni 136

Kryesit e punëve ndërtimore janë të obliguar të kujdesen për:

- a) pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ku ndërtohet, deri te vendi i shkarkimit të materialit;
- b) derdhjen e materialit shkapërderdhës dhe të pengohet pluhuri gjatë procesit të rrënimit;
- c) deponimin dhe sigurimin e materialit ndërtimor nga rrënimi dhe bartjen e tij nga sipërfaqja publike.

Neni 137

Personat fizikë dhe ata juridikë, të cilët bëjnë ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave ose të materialit para ndërtesave, në rrugë ose trotuare, janë të obliguar që menjëherë t'i largojnë ato dhe ta pastrojnë vendin.

Q. Pastrimi i borës

Neni 138

138.1 Për pastrimin e borës nga trotuaret dhe para ndërtesave afariste dhe banesore në pronësi shoqërore, kujdesen personat juridikë, të cilët i shfrytëzojnë ndërtesat afariste dhe pleqësitë shtëpiake, ndërsa për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave familjare banesore dhe para hapësirave afariste (punëtoritë, lokalet afariste), kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore dhe të hapësirave afariste.

138.2 Ndërmarrjet e ndryshme dhe qytetarët, janë të obliguar që, gjatë pastrimit të sipërfaqeve nga paragrafi 138.1 i këtij neni, ta grumbullojnë borën dhe akullin në skaj të trotuarit, ndërsa ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë është e obliguar që borën e grumbulluar në skaje të trotuarit, ta bartë menjëherë jashtë qytetit, më së voni brenda 10 orësh.

138.3 Ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë, me rastin e reshjeve të mëdha atmosferike, është e obliguar që nga rrugët, trotuaret, trafiku publik dhe ai i dorës së dytë, të kujdeset dhe rregullisht t'i pastrojnë ato nga bora dhe akulli dhe të hedhin kripë në to.

Neni 139

Në rastet kur gjatë ditës bie borë, trotuaret, sipas nevojës, duhet të pastrohen edhe disa here në ditë, dhe në rast se bora bie pandërprerë gjatë natës, ajo duhet të pastrohet në ditën e ardhshme, më së voni deri në orën 9:00 të mëngjesit.

Neni 140

Për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës komunale nëpër tregje dhe në objektet e tyre, kujdeset pronari, respektivisht shfrytëzuesi i tregjeve.

Neni 141

Tregjet duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër. Çdo ditë, pas mbarimit të kohës së punës, ato duhet të pastrohen mirë, të lahen dhe të të kthehen në gjendje të rregullt.

Neni 142

Ndërmarrja e cila menaxhon me tregjet, është e obliguar që në të gjitha tregjet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm, furnizim të rregullt për freskimin e prodhimeve dhe pastrimin e tregjeve, si dhe të ndërtojë numrin e caktuar dhe të nevojshëm të kabinave të nyjave sanitare, të cilat duhet të pastrohen dhe të mirëmbahen rregullisht, dhe të vihet numri i mjaftueshëm i enëve dhe kontejnerëve për mbeturina dhe fundërrina, të cilat duhet të pastrohen rregullisht.

Neni 143

Ndalohet:

- a) pastrimi i tregut dhe i vendeve për shitje, gjatë kohës së zhvillimit të afarizmit në treg;
- b) çdo shitje e mallit dhe e gjërave tjera ushqimore, jashtë vendit të caktuar për këtë qëllim;
- c) shitja dhe ekspozimi i mallrave në vendet dhe hapësirat në afërsi të tregut, që do të pengonte qasjen dhe qarkullimin e lirë të blerësve në hapësirat para tregut dhe në hyrje të drejtpërdrejtë të tregut, të cilat në çdo kohë duhet të jenë të lira për kalimtarë, blerës dhe trafikun e automjeteve dhe të mjeteve tjera;
- d) ekspozimi i mallrave në kundërshtim me kushtet e parapara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, dhe si pasojë bëhet konfiskimi i tyre nga ana e DSHPIISE

Neni 144

Në komunën e Mitrovicës së Veriut nuk lejohen tregjet e për shit-blerjen e kafshëve.

Neni 145

145.1 Hapësira e tregut për shitjen e materialit për ngrohje (dru) si dhe produkteve tjera nga druri, dhe të prodhimeve të ngjashme, duhet të mbahet në rregull, në gjendje të pastër dhe pas çdo dite pune në treg, duhet të pastrohet pas mbarimit të orarit të punës.

145.2 Ndalohet shitja e prodhimeve të theksuara – materialit, jashtë hapësirës së tregut të caktuar për këto destinime.

145.3 Ndalohet shitja e thëngjillit apo gëlqeres brenda Komunës Mitrovicës Veriut.

Neni 146

Në sipërfaqe publike ndalohet:

- 1) hedhja e mbeturinave jashtë shportave dhe enëve për mbeturina, ose krijimi i papastërtisë në sipërfaqe publike në mënyra tjera;
- 2) prerja dhe copëtimi i drurëve, dhe materialit tjetër, me përjashtim në parcela të zbrazëta, nëse për këtë ekziston leja për ndërtim të ndërtesave banesore dhe të tjera;
- 3) larja e të gjitha mjeteve motorike, rrobave dhe lëndëve të tjera;
- 4) meremetimi i automjeteve dhe kryerja e veprimtarive zejtare;
- 5) lëvizja e automjeteve në të cilat është grumbulluar balta dhe papastërti tjetër;
- 6) lëvizja e automjeteve, të cilat nuk janë siguruar nga materiali derdhës që transportohet, ose automjeteve që mundësojnë përhapjen e gazrave gjatë transportimit (fekalet) dhe materialit tjetër me erë kundërmuese, përveç lëndës së asfaltit;
- 7) lirimi dhe shpërndarja e ujit fundërrinor dhe ndyrësirave tjera në sipërfaqe publike, në oborret fqinje dhe në korridoret e përbashkëta, ose të hidhen në ato sipërfaqe dhe të mbahen mbeturinat e të ngjashme;
- 8) lëvizja e kafshëve dhe e shpezëve;
- 9) kryerja e nevojës së madhe dhe të vogël fiziologjike;
- 10) hapja e enëve me mbeturina (enëve dhe kontejnerëve);
- 11) prishja dhe marrja e lëndëve fundërrinore nga shportat dhe kontejnerët;

- 12) ndezja e mbeturinave nëpër enë dhe në sipërfaqe publike;
- 13) hedhja në enët për mbeturina e këtyre lëndëve: dheut, rërës, ambalazhit, mbeturinave nga kopshtet dhe mbeturina të ngjashme;
- 14) zhvendosja e dyerve dhe mbulesave (kapakëve) nëpër enët për mbeturina;
- 15) zhvendosja e enëve për mbeturina nga vendet e caktuara, pa lejen e organit për punët komunale;
- 16) përdorimi i enëve për mbeturinat me vëllim mbi 120 litra;
- 17) hedhja e mbeturinave dhe e fundërrinave të tjera jashtë enëve për mbeturina;
- 18) hedhja e hirit dhe të materialit tjetër ndezës në enët për mbeturina (kontejnerë);
- 19) rrjedhja e ujit nga krojet në oborr, rrugë dhe oborre të huaja;
- 20) mbajtja në gjendje jo të rregullt e hidrantëve për ujë nëpër rrugë;
- 21) ndalimi i automjeteve motorike pranë enëve për mbeturina, kontejnerëve, trotuareve, sheshe, sipërfaqeve të gjelbra etj.;
- 22) parkimi i të gjitha mjeteve motorike nëpër trotuare;
- 23) vendosja e tavolinave dhe karrigeve nëpër trotuare pa jellen e institucioneve lokale;
- 24) mbajtja e papastërtisë në hapësirën ku bëhet pastrimi i veshmbathjeve;
- 25) mbajtja e mbeturinave dhe fundërrinave nëpër enët, të cilat nuk i plotësojnë kushtet për këtë qëllim;
- 26) shtrirja e armaturës dhe lidhja për shtylla dhe drurë për t'i drejtuar ato në sipërfaqe publike, rrugë dhe trotuare;
- 27) dalja me automjete të ndotura nga vendi ndërtimor dhe nga sipërfaqet tjera të ngjashme në sipërfaqe publike të trafikut publik.

Neni 147

Në territorin e qytetit dhe në para lagje, ndalohet:

- a) nxjerrja e materialit ndërtimor, eksploatimi i fraksioneve të gurit nga prerjet e tullave skaj rrugëve publike e të ngjashme;
- b) lëshimi ose përcjellja e ujit fekal nga gropat e nyjave sanitare, si dhe mbeturinat e gropave septike nëpër kopshte, kanale, lumenj, rrugë dhe në oborre fqinje;
- c) hedhja dhe derdhja nëpër oborre ose para hapësirave të ndërtesave banesore, e mbeturinave, fekaleve, ujit dhe dëmtimi në çfarëdo mënyre i kushtet higjienike të qytetarëve të tjerë ose të banuesve;
- d) dhënia e ujit kafshëve nëpër krojet publike;
- e) hedhja dhe mbulimi i kafshëve dhe shpezëve të ngordhura jashtë varrezave të destinuara për kafshë;
- f) braktisja ose lidhja e mjetet tërheqëse në vendet në të cilat nuk janë caktuar për këto qëllime.
- g) prodhimi me dorë i tjegullave, tullave dhe përpunimi i gëlqeres.

Neni 148

Në gjithë territorin e komunës rreptësishtë ndalohet:

- a) djegia e gomave, vajrave motorike, plastikës, pesticideve, barnave dhe të gjitha mbeturinave tjera toksike;
- b) hedhja e vajrave motorike, pesticideve, barnave dhe substancave tjera toksike në sipërfaqe të tokës, në ujë dhe në kanalizim.

Neni 149

Për shërbimet të cilat i janë besuar ndërmarrjes për pastrimin e rrugëve të shtruara, largimin e borës dhe të akullit, transportimin dhe deponimin e tyre në sipërfaqe, në pajtim me këtë Rregullore, i takon kompensimi në lartësinë dhe në kushtet të cilat përcaktohen me kontratë dhe me tarifën e lejuar.

Neni 150

150.1 Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë, inspektori ka të drejtë të ndalë automjetin, i cili transporton mallra, material ndërtimor, material fundërrinor, dru, thëngjill etj.

150.2 Ndalimin e automjeteve në fjalë inspektori e bënë me paraqitjen e shenjës për komunikacion – “ndalohet trafiku në të dy drejtimet”, në të cilin shkruan “STOP INSPEKTORATI”, vozitësit e automjeteve janë të obliguar t’i ndalin automjetet në këtë rast dhe duhet t’i ofrojnë shënimet që kërkohen nga inspektorët.

150.3 Ndalimi i automjeteve nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk guxon të kryhet nëpër vende ku do të shkaktohet rrezikimi për sigurinë në trafik.

R. Furnizimi i lagjeve me energji termike

Neni 151

151.1 Furnizimi i lagjeve me energji termike (ngrohëse), nënkupton ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e rrjetit unik termik të qytetit në lagje dhe blloqe, të cilat ri konstruktohen dhe ndërtohen në territorin e qytetit dhe në vendbanime pranë qytetit.

151.2 Ndërtimi i sistemit dhe i objekteve të rrjetit termik të qytetit dhe të vendbanimeve afër qytetit, përcaktohet me planin rregullues urbanistik.

Neni 152

152.1 Në blloqet banuese e të tjera që do të ndërtohen, të cilat janë të përfshira me planin e ngrohjes nga paragrafi paraprak, duhet të përfshihen dhe të ndërtohen e montohen instalimet e ngrohjes qendrore, me lidhje në rrjetin unik termik të qytetit, në lagje ose në bllok, sipas planit urbanistik ose me vendim të Komunës, nëse për disa lagje dhe blloqe nuk është caktuar ndryshe.

152.2 Në objektet nga paragrafi paraprak, në të cilat duhet të ndërtohen dhe montohen instalimet e ngrohjes qendrore me lidhjen në rrjetin unik termik të qytetit, në lagje ose në bllok, nuk mund të parashihet dhe të ndërtohen kazanë për disa objekte, nëse ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e ngrohjes së qytetit, garanton që me ditën e marrjes së lejes për përdorim të objektit, do të mundësojë shfrytëzimin e ngrohjes, përpos objekteve të destinimit të veçantë, nëse ndërmarrja për furnizim me energji ngrohëse nuk i siguron kushte për lidhje.

Neni 153

Pronarët e ndërtesave të banimit në sektorin privat, të cilët posedojnë ngrohje qendrore ose ngrohje etazhi, janë të detyruar të lidhen në rrjetin termik publik në afat prej një viti prej ditës së ekzistimit të mundësisë teknike për lidhje në rrjetin termik. Shfrytëzuesi i ngrohjes qendrore nuk mund ta ndërrojë mënyrën e ngrohjes së lokaleve.

Neni 154

154.1 Financimi dhe ndërtimi i rrjetit unik termik të qytetit kryhet përmes të ndërmarrjes që merret me ngrohjen e qytetit, në bazë të planit të ngrohjes së qytetit.

154.2 Kompensimi për ngrohje të lokaleve me energji termike nga ngrohja e qytetit, paguhet sipas sipërfaqes së shfrytëzuar në m².

Neni 155

155.1 Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e ndërtimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të tërësishëm dhe të stabilimenteve për ngrohjen e qytetit, është e detyruar që ta mirëmbajë tërë sistemin, në mënyrë të përhershme, në gjendje të rregullt dhe të shfrytëzueshme.

155.2 Ndërmarrja nga pika paraprake, është e obliguar që konsumatorit të energjisë termike t’ia sigurojë, në mënyrë të përhershme, energjinë termike nga sistemi unik termik i qytetit deri te futja në objekt.

Neni 156

156.1 Ndërmarrja e cila furnizon qytetin me energji termike, është e obliguar të sigurojë ngrohjen e objekteve gjatë periudhës 15 tetor - 15 prill.

156.2 Përjashtim nga kjo do të ketë , në rast se temperatura e jashtme, në orën 13:00, është më e ulët se 14 gradë celsius, për tri ditë rresht.

Neni 157

157.1 Ndërmarrja nga neni paraprak, është e obliguar që gjatë periudhës së ngrohjes, të sigurojë temperaturën e ngrohjes së ujit prej së paku 90 gradë celsius në nënstacionet e objekteve, ku fitohet temperatura e nevojshme lokale.

157.2 Po që se në banesë ose lokale të tjera nuk sigurohet temperatura e nevojshme (prej 22 0 C) organizata është e detyruar që t'i mundësojë shfrytëzuesit të banesës ose të lokaleve të tjera që mund të shtojë numër të nevojshëm trupash për ngrohje, në mënyrë që të mund të sigurohet temperatura e dëshiruar. Këto punime kryhen sipas rregullit jashtë periudhës së ngrohjes.

Neni 158

Në bazë të kësaj Rregulloreje ndalohet:

- a) lidhja në rrjetin parësor të largpërçuesit termik, pa lejen paraprake të organit kompetent të administratës, pas pëlqimit paraprak të marrë nga ndërmarrja së cilës i janë besuar punimet për sigurimin e ngrohjes;
- b) dëmtimi i rrjetit parësor të ngrohjes (në pusetat termo, nënstacionet dhe në stabilimente të pompave).

6 MBIKËQYRJA

Neni 159

Mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje, e kryejnë organet kompetente të Institucionit lokal.

7 DISPOZITAT NDËSHKUESE

VËREJTJE: "Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës" UN-Habitat, nuk mundet dhe nuk ka kompetencë për të caktuar masat ndëshkuese të kësaj Rregulloreje. I mbete stafit lokal që të vendos se për cilat pika do të zbatohen masat ndëshkuese. Në vijim janë të paraqitura si shembull masat ndëshkuese të Komunës së Pejës, Komunës Prishtinës dhe Komunës Mitrovicës Jugut.

Neni 160

Ndërmarrjet e autorizuara për mbajtjen e pastërtisë, higjienës komunale dhe gjelbërimit, ndërmarrjet punuese, shkollat ose personat e tjerë juridikë, do të ndëshkohen me dënim në shumën prej 100 € deri 1000 €, nëse nuk u përmbahen dispozitave dhe masave, gjegjësisht:

- a) nëse nuk e kryejnë pastrimin e të gjithë mbledhësve të ujit dhe të pusetave për ujin atmosferik, së paku dy herë në vit (neni 6);
- b) nëse nuk e sigurojnë për konsumatorë sasinë e mjaftueshme të ujit higjienik dhe të rregullt (neni 9);
- c) nëse nuk e pengon çdo derdhje të tepër të ujit (neni 30);
- d) nëse nuk e kryen pastrimin e rregullt të mbledhësve të ujit dhe të pusetave për kanalizimin atmosferik dhe fekal, në mënyrë që në çdo kohë të mund t'i përgjigjet destinimit të vet (neni 33),
- e) pas kryerjes së punëve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të cilat ajo i kryen, dhe nuk e kthen gjendjen në terren ashtu si ishte më parë (neni 33);
- f) nëse nga rrugët, trotualet dhe sipërfaqet publike nuk e largon materialin e tepërt, në afatin e paraparë me vendimin nga ana e organit kompetent (neni 34);

- g) nëse i shfrytëzojnë sipërfaqet e gjelbra jashtë suazave të tyre pa lejen e organit kompetent (neni 44);
- h) nëse nuk i eviton dëmet në rrugët e trafikut, trotualet dhe nëse terrenin nuk e kthen në gjendjen e mëparshme, të rregullt (neni 56);
- i) nëse gjatë shfrytëzimit të trotuarit, rrugës dhe sipërfaqes tjetër publike vjen deri te dëmtimi i tyre (neni 55);
- j) nëse kryen ndonjë veprim të ndaluar (nenin 69);
- k) nëse nuk vepron në pajtim me nenin 71;
- l) nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 76 dhe 77;
- m) nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 79;
- n) nëse nuk e kryen aranzhimin profesional të artikujve nëpër vitrina, nuk i shkruan çmimet e artikujve me material të njëjtë, nuk e paraqet me shkrim orarin e punës (neni 81),
- o) nëse vërtetohet nga ana e organit kompetent dhe vlerësohet se rrëmihja dhe evitimi i prishjes nga neni 108, paragrafi 1, nuk ka qenë i natyrës urgjente (neni 108);
- p) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 110;
- q) nëse, kur bie borë, nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 136, shkronjat: a, b dhe c,
- r) mbështetur në nenet, nga 5 deri 22 dhe nenet: 29, 32, 33, 44, 50, 55, 69, 79, 85, 108, 110, 140, dhe 150 të këtij vendimi, do të dënohen për kundërvajtje, me të holla në shumën prej 50 €, edhe personi përgjegjës në ndërmarrjen e autorizuar për mirëmbajtjen e higjienës komunale dhe gjelbërimit, ndërmarrja punuese, organi shtetëror, organizata, shkolla apo personi tjetër juridik, nëse kundërvajtja është bërë si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij.

Neni 161

161.1 Ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë, higjienës komunale dhe gjelbërimit, ndërmarrja punuese, organizata, organi shtetëror, shkolla dhe personi tjetër juridik, do të ndëshkohet për kundërvajtje, me dënim në shumë prej 100 € deri 800 €, nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara me këto nene, gjegjësisht:

- a) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e parapara të nenit 11 dhe 12;
- b) për shkak të kyçje pa leje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (neni 18);
- c) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 dhe 35;
- d) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: ?, 45, 46, 47, 51 dhe 54;
- e) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 68, 70, 71, 73 dhe 74;
- f) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 77, paragrafi: 1, 2 dhe 3.
- g) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 60, paragrafi 1 dhe 2;
- h) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 84, 86 dhe 88;
- i) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nenit 92 dhe nenit 93, paragrafi: 1, 2 dhe 3;
- j) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 94;
- k) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 117;
- l) nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara me nenet: 109, 110, 111, 112 dhe 115;
- m) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e parapara me nenin 121,
- n) nëse nuk sillet në pajtim me nenet: 122 dhe 123;
- o) nëse nuk e bën shpëlarjen e rrugëve dhe pastrimin, në pajtim me kontratën në mes të organeve përkatëse të Administratës komunale dhe ndërmarrjes punuese kompetente (nenet: 129, 130);
- p) nëse nuk e siguron numrin e mjaftueshëm të enëve speciale dhe kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave nga të gjitha hapësirat punuese dhe sipërfaqet e lira (neni 133);
- q) nëse vepron në kundërshtim me nenet: 135 dhe 136;

- r) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 138;
- s) nëse nuk e bën pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ndërtimore, nëse nuk e spërkat materialin e grimcuar gjatë rrënimit, në mënyrë që të mos ngjitet pluhuri (neni 141);
- t) nëse bie ndesh me masat e përcaktuara në nenin 139;
- u) nëse nuk vepron në mënyrën e paraparë sipas neneve: 143 dhe 144, pas rënies së borës;
- v) nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara me nenet: 145, 146, 147 dhe 148;
- y) nëse nuk i respekton nenet: 149, 150 dhe 151;
- z) nëse me rastin e paraqitjes së shenjës së komunikacionit "STOP-INSPEKTORATI", vozitësit e automjeteve të rënda nuk i përmbahet shenjës për ndalesë dhe nuk ia ofrojnë inspektorit shënimet e kërkuara (neni 151).

161.2 Mbështetur në nenin 163, shkronjat: k, l, m, n, o dhe p, do të dënohet për kundërvajtje me shumën prej XXX € deri XXX €, personi përgjegjës në ndërmarrjen e autorizuar për mirëmbajtjen e higjienës dhe personi tjetër juridik, në rast se kundërvajtja është bërë për shkak të veprimit apo mosveprimit të tij.

Neni 162

Qytetari - personi dhe pronari i punëtorisë, i cili merret me veprimtari ekonomike ose me veprimtari zejtare, do të dënohet për kundërvajtje, me dënim në të holla në shumë prej 100 € deri 500 €, nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara nga këto pika, gjegjësisht:

- a) nëse bën kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit pa lejen përkatëse (neni 18);
- b) nëse bën ndonjërin prej veprimeve të ndaluara nga neni 35, shkronjat: a, b, c, d, e, f, g, dhe h;
- c) nëse bën ndonjërin prej veprimeve të parapara sipas nenit 53, paragrafët: nga 1 deri 18;
- d) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 55;
- e) nëse vepron në kundërshtim me nenin 56, paragrafët: 3, 4 dhe 5;
- f) nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara me nenet: nga 68 deri 75;
- g) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 76, 77, dhe 78;
- h) nëse nuk vepron në bazë të Aktvendimit të organit të institucionit lokal respektivisht DSHPIISE , respektivisht nëse nuk i eviton mungesat në afatin e caktuar (neni 79);
- i) nëse nuk e eviton rrezikun nga rrënimi i objekteve, i cili paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, të objekteve fqinje dhe sigurinë në trafik (neni 79);
- j) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 84, 85, 86 dhe 87;
- k) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 101;
- l) nëse nuk e bën dezinfektimin e nyjave sanitare dhe gëlqerosjen e tyre të paraparë me nenin 98;
- m) nëse bën ndonjërin prej veprimtarive të ndaluara sipas nenit 93;
- n) nëse nuk iu përmbahet masave të caktuara nga nenet: 109, 110, 111, 112 dhe 115;
- o) nëse bën ndonjërin prej veprimeve që bie ndesh me nenin 125;
- p) nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara në nenin 140;
- q) nëse nuk respektohen dispozitat e neneve: 143 dhe 144;
- r) nëse kryen ndonjërin prej veprimeve të ndaluara në bazë të nenit 146, paragrafi 1, respektivisht nga pika 1 deri në pikën 27;
- s) nëse gjatë paraqitjes së shenjës së komunikacionit nga ana e inspektorit komunal "STOP-INSPEKTORI", vozitësit e automjeteve të rënda nuk ndalen dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkuara nga inspektori (neni 150).

Neni 163

Qytetari, individi dhe pronari i punëtorisë zejtare, i cili merret me ekonominë e pavarur ose me veprimtarinë zejtare, do të dënohen për kundërvajtje, me dënimin në të holla në shumën prej 50 € deri 200 €, nëse nuk iu përmbahet dispozitave dhe masave të parapara sipas këtyre neneve, gjegjësisht:

- a) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 35;
- b) nëse i shfrytëzon sipërfaqet publike të gjelbra jashtë destinimeve të tyre themelore pa leje nga organi kompetent (neni 46);
- c) nëse bën ndonjërin nga veprimet e ndaluara në bazë të nenit 57, paragrafi: 1 dhe 2;
- d) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 60;
- e) nëse bën ndonjërin prej veprimeve të ndaluara në bazë të nenit 70, paragrafi: 1 dhe 2;
- f) nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara në nenin 78;
- g) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve 81 dhe 82;
- h) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 93;
- i) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 94, 95;
- j) nëse nuk e kthen terrenin në gjendjen e mëparshme, të rregullt, në sipërfaqen e rrëmihur të paraparë sipas nenit 111;
- k) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 122,123 dhe 126;
- l) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 129,132 dhe 133;
- m) nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara sipas nenit 140;
- n) nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara nga nenet: 145 dhe 146;
- o) nëse bën ndonjërin prej veprimeve të ndaluara sipas nenit 148, shkronjat: a dhe b;
- p) nëse bën ndonjërin prej veprimeve të ndaluara sipas nenit 150, paragrafi: 1, 2 dhe 3.

Neni 164

Për kundërvajtjet e caktuara me këtë Rregullore, të cilat i bëjnë personat e moshës jo madhore, gjegjësisht të rinjtë, do to dënohen me gjobë prindërit e tyre, respektivisht kujdestarët.

Neni 165

Për shkaktimin e kundërvajtjes sipas neneve: 36, 53, 59, 69, 87, 88, 103, 104, 105, 121, 122, 123, 124, 126, 127, 128, 129, 144, 145, 146, 147, 149, 150, 151, 153, inspektorët komunalë kanë autorizime të shqiptojnë dënime (gjoba) mandatorë, në shumë prej 25 € deri 100 €, për individët dhe personin përgjegjës, kurse personin juridik dhe individin në kryerjen e veprimtarisë së pavarur, në shumën 1000 €.

8 DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 166

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret e mëparshme.

9 HYRJA NE FUQI

Neni 167

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore.

Mitrovicë Veriore.

Dorëzohet:

- 1x1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1x1 MAPL
- 1x1 Arkivitet
- Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha Drejtorive





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Erden Atiq, Kryetare e Komunës së M.Veriut Nexhat Uglanin, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së M.Veriut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, UD. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, UD. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 17.10.2023
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Ramadan Fotera, Zyrtar për monitorim të komunave	Nr. IV-0-801
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së M.Veriut	
Lloji i aktit:	Rregullore	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullorja Komunale nr.01/2023
I miratuar më datë: 11.10.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 12.10.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**. Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së M.Veriut në mbledhjen e mbajtur me datë 11.10.2023, ka miratuar *Rregulloren Komunale nr,01/2023 për Shërbimet Komunale në M.Veriore.*

MAPL, konstaton së Rregullorja e nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së M.Veriut është bazuar në Ligjin Nr- 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale neni 12.1,dhe 12.2,pika a,b,c,d.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.